


RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit MSc “Shkenca Themelore Islame”
Ofruar nga Kolegji Universitar “Beder”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Gjergj Sinani
Dr. Zana Strazimiri



(Maj/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Shkencor në “Shkenca Themelore Islame”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Beder”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Humane
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licencuar me UMASH Nr. 218, datë 28.05.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Master Shkencor në “Shkenca Themelore Islame”
6	Cikli i studimit:	Cili i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Kohë të Plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Turke
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (Shtatë)
16	Numri i Studentëve	13 Studentë



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në “Shkenca Themelore Islame”

Programi MSc në “Shkenca Themelore Islame” organizohet nga Departamenti i Shkencave Islame. Ky departament është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane, në Kolegjin Universitar “Beder”. Nevoja e krijimit të Departamentit, me programe të dy cikleve, është e lidhur me faktorë specifikë, historikë e social kulturorë. Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri pas viteve 90, i shoqëruar me të drejtën e ushtrimit të lirisë së besimit e rihapjen e objekteve të kultit, si dhe riinstitucionalizimin edhe të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, shtroi nevojën e njerëzve të kualifikuar, që do shërbenin si imamë e edukatorë islamë në xhamitë apo medresetë e rihapura. Programi Master Shkencor në “Shkenca Themelore Islame”, është licencuar me UMASH Nr. 218, datë 28.05.2012 dhe akreditimi i parë është realizuar me UMASH Nr. 223, datë 04.06.2013 nga APAAL dhe në vitin 2017, ky vlerësim për programet e studimit të ofruara, është rikonfirmuar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë. Institucioni ka marrë certifikatën e cilësisë ISO 9001:2008. Institucioni ka marrë certifikatën e cilësisë ISO 9001:2008. (evid.nr.17).

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Gjergji Sinani dhe Dr. Zana Strazimiri, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Draft-Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 21.05.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.6/61 prot. Datë 21.05.2019. Institucioni ka sjellë me anë të shkresës nr. 147/29 prot. Datë 24.05.2019, komentet mbi draft raportin.

GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

-Për komentin: *Që nga themelimi i KU Bedër, Departamenti i Shkencave Islame në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ka zhvilluar disa konferenca kombëtare dhe programe trajnimi për të gjithë myftinitë (mbi 600 imamë të trajnuar), duke iu dhënë atyre vizionin e Islamit tradicional në trojet shqiptare, si një religjion që bashkëjeton me të gjitha besimet e tjera dhe kontribuon për gjithë shoqërinë pa dallim feje. Krahas kësaj janë organizuar disa simpoziume studentore rreth kontributit të prijësve myslimanë shqiptarë, në ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar. Reth këtyre temave studentët nxiten të shkruajnë dhe të hartojnë projekte si dhe teza Bachelori dhe Masteri në këtë fushë.* GVJ vlerëson përpjekjet e insitucionit, duke e evidentuar gjërësisht në raport ecurinë pozitive të departamentit në drejtim të promovimit të vlerave kulturore kombëtare por megjithëatë sugjeron që të vazhdohet dhe të thellohet më tej kjo traditë, për shkak të rëndësisë në situatën aktuale. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Lidhur me këtë janë bërë ndryshimet e nevojshme të paraqitura në dosjen e riorganizimit dorëzuar MASR.* GVJ vlerëson iniciativën e insitucionit për riorganizimin e programit, por thekson se në analizen e vet nuk ka patur për objekt shqyrtimi e vlerësimi dosjen e riorganizimit dorëzuar në MASR por vlerësimin e programit master e sylabuseve të lëndëve pas akreditimit të parë, si ato janë realizuar deri tani. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Për komentin: *Në dosjen e riorganizimit janë paraqitur ndryshimet dhe shtimi i lëndëve të reja, të cilat do të bëjnë dallimin midis dy programeve Master.* GVJ vlerëson iniciativën e insitucionit për riorganizimin e programit, por thekson se në analizen e vet nuk ka patur për objekt shqyrtimin e vlerësimi dosjen e riorganizimit dorëzuar në MASR por vlerësimin e programit master e sylabuseve të lëndëve pas akreditimit të parë, si ato janë realizuar deri tani. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Për komentin: *Për arsye të mungesës të stafit të gjinisë femërore, të kualifikuar në shkenca islame deri vitin e kaluar ka pasur një vakum. Duke filluar nga viti akademik 2018-2019 është rekrutuar një personel akademik me kohë të plotë e diplomuar në Shkenca Islame në programet Bachelor dhe Master në Bedër, si një asistente kërkimore, aktualisht studente në vitin e dytë master, e diplomuar në Bachelor, Shkenca*

Islame si studente ekselente në rang IAL. GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për rekrutimin e personelit të gjinisë femër gjë e cila është vënë në dukje edhe në raport, por sugjeron që kjo të vazhdojë edhe në të ardhmen. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Për komentin: *Metoda e hermeneutikës në Shkencat Islame përfshihet në lëndët e komentimit dhe interpretimit të Kuranit që në literaturën Islame njihen me emrin Metodologjia e Tefsirit dhe Ekolet e Tefsirit. Për këtë arsye është parashikuar që lënda e metodës së kërkimit shkencor të këtë karakter sociologjik dhe jo teologjik.* GVJ sqaron se Hermeneutika nuk është vetëm teologjike. Përveç kësaj edhe në metodat e kërkimit shkencor ka metoda fenomenologjike, ka metoda kuptimore dhe jo vetem statistikore. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Sigurimi i literaturës së shkruar në gjuhën shqipe, për të ndihmuar studentin gjatë kërkimeve shkencore, për shkak të mungesës së literaturës në gjuhën shqipe.
- b) Rritja e numrit të personelit akademik shqiptar
- c) Krijimi i kushteve që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Nga shqyrtimi i RVB për MSc në “Shkenca Themelore Islame”, nga takimet e GVJ në Departamentin e Shkencave Islame me përgjegjësin dhe stafin akademik dhenjohja me dokumentacioni përkatës, rezulton si më poshtë:

1. Për rekomandimin “*Të sigurohet literaturë e shkruar në gjuhën shqipe për të ndihmuar studentin gjatë kërkimeve shkencore, për shkak të mungesës së literaturës në gjuhën shqipe*”, institucioni ka marrë masa duke pasuruar Bibliotekën e IAL me literaturë në gjuhën shqipe, që vjen kryesisht nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë dhe Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, si dhe shtëpi të tjera botuese. Aktualisht, në bibliotekën e universitetit gjenden rreth 7200 tituj lidhur me fushën e shkencave islame, ku rreth 30% e tyre janë në gjuhën shqipe, (“Informacion rreth pasurimit të bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe”, evid. shtesë. Nr.14). **Ky rekomandim është përmbushur.**
2. Për rekomandimin “*Të rritet numri i personelit akademik shqiptar*”, institucioni ka marrë masat dhe është shtuar personeli akademik shqiptar, i inkuadruar në stafin akademik të departamentit. Nëse për vitin akademik 2014-2015, sic rezulton nga të dhënat e RVB, Departamenti kishte dy pedagogë shqiptarë efektivë (MA) dhe dy me kontratë (MA dhe Msc), ky numër ka ardhur duke u rritur, në varësi të procesit të kualifikimit dhe plotësimit të kushteve për personel akademik. Në vitin akademik 2016-17 vihet re një ndryshim i theksuar në përbërjen dhe kualifikimin e stafit shqiptar; përgjegjësi i departamentit është pedagog shqiptar, me gradën “Dr” dhe stafi ka në përbërje 5 pedagogë efektivë shqiptarë dhe 4 me kontratë. Në vitin akademik, 2017-18 numri i pedagogëve shqiptarë me kontratë është rritur në 6, ndërsa për vitin akademik 2018-19, nga 14 pedagogët që përbëjnë stafin (11 efektivë e 3 me kontratë), vetëm 3 janë me kombësi të huaj. Midis stafit shqiptar, vetëm një i takon gjinisë femërore (Msc, asistente/lektore), rekrutuar për vitin akademik 2018-19. Për vitin akademik 2018-19, përgjegjësi i departamentit është me kombësi shqiptare, tashmë prej tre vitesh. Në këtë staf, vetëm një është me titullin “Prof i Asoc”, 5 janë me gradën “Dr” (një me kontratë), tre janë në proces doktorature (një me kontratë) dhe pjesa tjetër e stafit janë Msc, si asistentë lektorë.

Një ngërç insitucional, që e ka frenuar shtimin e personelit akademik shqiptar, ka qënë e mbetet problemi i njohjes dhe i ekuivalentimit të diplomave të studentëve shqiptarë, që kanë studjuar në universitetet e huaja për teologji islamike, me argumentin se MASR nuk ka ekspertë në këtë fushë.

Një pengesë tjetër institucionale është se MASR nuk ka të aprovuar edhe programin e studimeve doktorale në fushën e shkencave islame, cka do inkurajonte dhe shtonte numrin e stafit akademik shqiptar të kualifikuar pranë departamentit.

Një faktor nxitës për shtimin e pedagogëve shqiptare do jetë edhe miratimi, që pritet nga MASR, i projektit të riorganizimit të Departamentit në gjuhën shqipe.(Riorganizimi i programit “Master i Shkencave” në Shkenca Themelore Islame, evid.nr.38). **Ky rekomandim është përmbushur.**

3. Për rekomandimin *“Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e teksteve të njohura ndërkombëtare”* institucioni ka realizuar që dëshmia e mbrojtjes së gjuhës angleze, ose e katër gjuhëve të tjera të përdorura në BE e të miratuara nga MASR, të vlerësuara me një nga testet e njohura ndërkombëtare, të paraqitet që në momentin e regjistrimit në programin Msc. (GVJ verifikoi dosjet e studentëve pranë sekretarisë mësimore). **Ky rekomandim është përmbushur.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që i referohet programit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, si Statuti i KUB (evid. nr.1); Rregullore Themelore e KUB (evid.nr.2), RVB për programin në fjalë, Plani Strategjik i Institucionit 2018-23 (evid. nr. 13), plani mësimor me kurrikulat e përmbajtjen e programeve të lëndëve, (evid. shtesë. Nr.1), por edhe nga takimet me stafin akademik dhe titullarët e institucionit (dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, pjesë e të cilit është departamenti dhe përgjegjësin e departamentit), bëhet e qartë se ky program studimi i ciklit të dytë, në qëllimet e objektivat e tij synon të mbulojë një tematikë e metodikë të gjërë, që buron nga thellimi në studimin e një sërë disiplinash në fushën e fesë e kulturës së botës islame, të historisë, gjuhës, politikës, shoqërisë, legjisllacionit, filozofisë e sociologjisë së fesë islame, edukimit, e çështjeve bashkëkohore të lidhura me to. Programi ofron bazën teorike për përgatitjen e formimin e një individi të aftë, racional, që kultivon mendimin kritik e që nuk është vetëm mbrojtës i traditave më të mira të Islamit, por që di të përballet me sfidat e problemet e botës bashkëkohore e që ka si synim t’i kontribuojë forcimit të harmonisë shoqërore.

Programi, në konceptimin e realizimin e tij, mban parasysh edhe synimin e institucionit për formimin e edukimin e të rinjve me shprehje e aftësi të punës kërkimore-shkencore, ndërveprues, që gjenerojnë idetë reja dhe ndikojnë pozitivisht në ndryshimin shoqëror e kulturor, në zhvillimin e paqes e bashkëpunimit ndërfetar. Përgjithësisht, në objektivat e veta, departamenti synon motivimin e studentëve dhe personelit për rritjen e efektivitetit lidhur me përgjegjësinë e tyre morale, profesionale e shoqërore.

Nga njohja me të dhënat e punësimit të studentëve të departamentit të Shkencave Islame (Model i raportit vjetor të departamentit, evid. nr.20), rezulton se programi që ofron departamenti i Shkencave Islame i përgjigjet nevojës së përgatitjes të të kuadrove fetarë për të gjitha instancat e KMSH-së brenda vendit, të formimit dhe konsolidimit të brezave të profesionistëve të rinj në fushën e shkencave islame, të teologëve e edukatorëve të institucioneve arsimore islame, me fizionomi të qartë kombëtare.

Në Departamentin e Shkencave Islame, me përfundimin e plotë të programit me ciklin e dytë MSc, si në “Shkenca Themelore Islame”, ashtu edhe në “Shkenca Moderne” çelët mundësia që studentët të vijnë në studimet në ciklin e tretë, doktoraturë, në institucione publike dhe private brenda dhe jashtë vendit, por edhe të kryejnë studime pasuniversitare në fusha të tjera të Shkencave Sociale, si histori, psikologji, sociologji, filozofi, etj., brenda dhe jashtë vendit, hapësirë e cila i ndihmon të diplomuarit që të kenë mundësi punësimi jo vetëm brenda instancave të KMSH-së, por edhe në institucione të tjera publike dhe private në Shqipëri, rajon dhe në botë.

Misioni i Departamentit të Shkencave Islame, për programin MSc në “Shkenca Themelore Islame” është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të KUB me standardet ndërkombëtare, si edhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjërë. Departamenti është përpjekur të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, duke nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen aktive të personelit akademik dhe studentëve në projekte dhe veprimtari kërkimore-shkencore, duke organizuar panele, seminare, simpoziume, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, shkolla verore, si në Austri dhe Egjipt. Ndër aktivitetet jashtë kurrikulare të studentëve, rëndësi i është dhënë aktivizimit të tyre në aktivitete sociale dhe kulturore, nëpërmjet klubeve studentore. Rëndësi e veçantë, në kuadër të objektivave strategjike që lidhen me kërkimin shkencor, i është kushtuar botimit të artikujve shkencorë të stafit akademik, por edhe punimeve më të mira të studentëve, nga projektet apo tezat e diplomave të ciklit të parë dhe të dytë MSc. Synohet, si strategji, e mishëruar kjo në tematikat e aktiviteteve shkencore, por edhe social-kulturore, të ruhet dhe forcohet tradita e një Islami shqiptar, kundër influencave të ndryshme të një Islami radikal, në përputhje me kërkesat më imediate të realitetit bashkëkohor. (Aktivitetet akademike të departamentit të Shkencave Islame, evid.nr. 34). Departamenti i Shkencave Islame është pjesë e një protokollit të zgjeruar marrëveshjes të KUB me institucione partnere, brenda dhe jashtë

Shqipërisë, si një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë dhe strategjisë së institucionit, që i kontribuon forcimit të cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor. (Institucionet partnere, evid.shtesë nr.7)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Nga takimet me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame, GVB dhe shqyrtimi i RVB etj, rezulton se programi studimit MSc në “Shkenca Themelore Islame” është në përputhje me objektivat dhe misionin e Kolegjit Universitar “Bedër”, për të promovuar një kuptim të drejtë të Islamit, kulturës dhe qytetërimit të tij si dhe për të nxitur mirëkuptimin reciprok midis shtresave të ndryshme të shoqërisë. Në përgjithësi, programi i shërben formimit të një specialisti të fushës, duke edukuar cilësitë dhe aftësitë e leximit dhe perceptimit të burimeve themelore të studimeve islame, njohës të nevojave dhe informacionit në këtë fushë, me cilësi etike, estetike, kulturore dhe profesionale. (Lista e plotë e sylabuseve të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, evid.nr.27). Programi, me kurrikulën e tij, kontribuon edhe në përhapjen e mesazhit paqësor të Islamit në rajon e më gjerë.</p> <p>Nga takimet në Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, me përgjegjësën e Departamentit të Shkencave Islame dhe nga shqyrtimi i dokumentacionin përkatës, evidentohet se ky program MSc, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri, i diktuar nga nevojat e KMSH, i shërben formimit dhe plotësimit të kuadrove të ketij institucioni ne rang kombëtar. Shumica e të diplomuarve, punësohen në institucionet e dikasteret e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pranë drejtorive të saj në Selinë Qendrore, filialeve në rrethe, nëpër medresetë e qyteteve kryesore, në kurse dhe qendrat kulturore, revistat, mediat e shkruara, radion e KMSH-së “Spektrum”, si dhe në Kolegjin Universitar “Bedër”, si specialistë të marrëdhënieve ndërkulturore dhe ndërftare në institucione dhe organizata qeveritare dhe OJF të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (Model i raportit vjetor institucional.evid.nr. 34, model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr.20, etj). Sipas RVB, “në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e nevojshme për licensim, KUB, me anë të ekspertëve ka bërë një studim të tregut të punës. Në përfundim të studimit u vendos për programet që do të ofrohen”. Sipas të dhënave nga raporti vjetor institucional 2017-2018 dhe raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2017-2018 (të sipërcituara), ka evidenca të punësimit të të diplomuarve në një masë të konsiderueshme. Sipas të dhënave nga këto raporte, rezulton se mbi 85 % e të diplomuarëve në departamentin Shkenca Islame janë të angazhuar me punë në institucione të ndryshme në Shqipëri dhe në disa shtete të ndryshme. Institucioni ka përgatitur një studim të tregut të punës për periudhën që ka kaluar nga akreditimi i parë. Ky studim është kryer në vitin 2017 dhe përmban analiza të detajuara të tregut dhe</p>

	<p>nevojave të tij për specialistë dhe njohës të mirë të fushës së shkencave moderne islame dhe shkencave teologjike në përgjithësi.</p> <p>Duke iu referuar RVB e dokumentacionit themelor të institucionit, misionit e vizionit të tij si dhe objektivave strategjike, programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, duke i lidhur qëllimet e programit me nevojat e këtij zhvillimi.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit të studimit MSc në “Shkenca Themelore Islame” (Lista e plotë e syllabuseve të programit “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, evid.nr.28), dokumentacionin përkatës të raporteve vjetore të institucionit e departamentit (të sipërcituara), objektivat e “Planit strategjik të KUB 2018-2023”, evid.nr. 13, informacionin mbi “Aktivitet akademike të Departamentit të Shkencave Islame 2013-2018, evid.nr.34, nga takimet me dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjës in e Departamentit të Shkencave Islame dhe stafin akademik të programit, konstatohet se programi është konceptuar në përputhje me strategjinë e misionin e KUB dhe departamentit në vecanti, që të formojë e të kultivojë tek studentët vlerat më të mira të traditës islame në Shqipëri e trojet shqiptare më gjërë, historinë, kontributet e vlerat e saj për realitetin bashkëkohor e atë shqiptar në drejtim të forcimit të paqes e bashkëjetesës ndërjetare, të nxitjes së dialogut ndërjetar dhe luftës kundër ekstremizmit e radikalizmit në tërësi. Ndonëse në program nuk ka lëndë të posacme të kësaj natyre, nga biseda me stafin e programit, bëhen përpjekje për të integruar, brenda përmbajtjes së tematikave përkatëse të lëndëve të vecanta, çështje dhe debate që i shërbejnë këtij qëllimi. Edhe tezat e studentëve orientohen në njohjen e ruajtjen traditës kulturore fetare e vlerave kombëtare.(Model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr.20)</p> <p>Nga pikëpamja e aktiviteteve shkencore, rezulton se Departamenti ka zhvilluar një sërë aktiviteteve kulturore e shkencore gjatë gjithë periudhës pas akreditimit të parë, për promovimin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërjetare, si në bashkëpunim me IAL-të e tjera teologjike në Shqipëri, ashtu edhe me partnerë ndërkombëtarë. Në panele, simpoziume, konferenca e aktivitete sociale të karakterit kombëtar e ndërkombëtar. <i>Sidoqoftë, duke mbetur një problematikë e mprehtë dhe aktuale, tematika që i shërben ruatjes dhe forcimit të vlerave kulturore kombëtare, kërkohet që të pasurohet edhe më tej, në format e qasjet e saj.</i></p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit dhe strategjisë së përgjithshme të KUB (dokumente të sipërcituara), por edhe nga biseda me Dekanin e përgjegjës in e departamentit e stafit përkatës të programit, rezulton qartë se vizioni i tij është në përputhje me misionin e strategjinë përgjithshme të KUB dhe të Departamentit por edhe me standardet ndërkombëtare. Programi është konceptuar në përputhje me strategjinë e institucionit, për të përgatitur</p>

	<p>studentë të aftë për të menduar në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për t'i përgatitur për sfidat e ardhshme, për t'i edukuar ata mëfort me shprehje praktike, për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës, për rritjen e mundësive e përvojave ndërkombëtare të studentëve, për rritjen e efektivitetit e cilësisë së kërkimit shkencor si nga ana e stafit akademik, ashtu edhe te studenteve. Për natyrën specifike që ka departamenti, ky program përpiqet të realizojë objektivat që lidhen me situatën fetare në Shqipëri e detyrën për të kontribuar në forcimin e mjedisit të paqes e bashkëjetësës ndërfaqetare në Shqipëri e luftës ndaj cdo forme të ekstremizmit e radikalizimit fetar. Objektivat pasqyrohen edhe në planin strategjik të institucionit 2018-2023 (evid. Nr.13)</p>
--	---

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

	<p>Programi i studimit është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, e vërtetuar kjo edhe nga akreditimi i parë i realizuar. Gjithashtu programi është bazuar në Kartën e Bolonjës, që përcakton ndarjen e grupimin e lëndëve në kurrikulën e programit Master. (RVB, rubrika.8 mbi Politikat e formimit të studentëve, me tabelat e planeve mësimore, Lista e plotë e sylabuseve të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame, evid.nr.28).</p> <p>Programi i i pajis studentët me njohuri të avancuaranë fushën e problematikave kryesore të shkencës së Hadithit, problematikave moderne të Kelamit, të Jurisprudencës e Historisë, por edhe të lidhjeve midis Fesë e Shkencës, të Sociologjisë së Fesë (në këtë rast duhet parë emërtimi i lëndës, pasi figuron si Sociologji Fetare), të rrymave moderne të filozofisë, të edukimit fetar, etj. Gjithashtu programi u jep studentëve edhe parimet e metodologjinë e kërkimit për fusha të caktuara , si Shkencat Sociale, Jurisprudencën Islame, metodat e interpretimit të Hadithëve, etj, .</p> <p>Në hartimin e programit të studimit, është marrë parasysh që emërtimi i programit të studimit të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. (niv.7)</p> <p><i>Problemi që vihet re lidhur me përmbajtjen e programit e sylabuset përkatëse, është se një pjesë e madhe e lëndëve janë të njëjta me ato të programit tjetër të ciklit të dytë të departamentit, atë të MSc në “Shkenca Moderne Islame”. Kjo vërejtje është bërë edhe me pare, në raportin e vlerësimit të jashtëm të kërkuar nga IAL, me sugjerimin e ndryshimit të lëndëve ose të profilizimit të programeve në një të vetëm (7.12.2014, evid.nr.25). Sidoqoftë, Departamenti është në pritje të miratimit nga MASR të kërkesës, bërë në shtator 2017, për riorganizimin e programit, me emërtimin MSc në “Shkenca Islame”. (“Shkresë derguar MASR për riorganizimin e programit”, evid.shtesë nr. 9)</i></p>
--	---

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxëniet.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Referuar RVB, institucioni ka pasur një plan strategjik për vitet 2012-2017. Është miratuar, në vazhdimësi, plani strategjik 2018-2023, që përmban strategjine përkatëse, në nivel institucional, për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. (Plani strategjik i KUB 2018-2023. evid.13)</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Në objektivat strategjike të departamentit e vizionin e tij (Raporti vjetor i Departamentit 2017-2018, evid.nr.20) pasqyrohen, nisur nga strategjia e përgjithshme e KUB, synimet e masat për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, evidentuar edhe në procedurat e vetëvlerësimit, rekrutimit të stafit, trainimeve, etj, të kryera në nivel departamenti. Gjithashtu, edhe forcimi i kërkesës ndaj kërkimit shkencor, i angazhimit të studentëve në punën kërkimore, rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shtimit të literaturës në gjuhën shqipe etj, janë indikatorë për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies e të nxënit. Ky objektivi është pasqyruar edhe në Planin strategjik të KUB 2018-2023. (evid.13).</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga studimi i RVB e i dokumentacionit perkates si dhe nga takimet në institucion me titullarët e Fakultetit dhe të Departamentit dhe stafin përgjegjës të programit, konkludohet se:

- a. Programi MSc në “Shkenca Themelore Islame”, me kurrikulën që ofron dhe elementët përbërës të saj, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Departamentit për edukimin e formimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e studimeve islame dhe të çështjeve bashkëkohore të lidhura me to. Programi ka si specifike qasjen e analizës së thelluar e metodologjisë kërkimore në shkencat bazë të Islamit. Programi i përgjigjet nevojave të tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
- b. Kurrikula e programit dhe aktivitetet mbështetëse i shërbejnë edukimit dhe forcimit të traditës, ruajtjes dhe promovimit të vlerave kulturore të kombit si dhe forcimit të dialogut ndërfaqetar. Veçanërisht, në tematikat e veprimtarive shkencore, konferencave, seminareve e aktiviteteve social- kulturore zenë vend çështje të rëndësishme, që i shërbejnë rolit e promovimit të dialogut e harmonisë ndërfaqetare në vend e më gjërë.
- c. Programi është në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare, duke kontribuar edhe me qasje që burojnë nga specifika e fenomenit fetar në Shqipëri.
- d. Programi është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me Kartën e Bolonjës, dhe me Kornizat Bazë Shqiptare të Kualifikimit.
- e. Departamenti, në hapjen e këtij programi, ka mbajtur parasysh strategjinë e KUB, duke hartuar një plan strategjik në nivel institucional për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Grupi i vlerësimit është i mendimit se programi MSc në “Shkenca Themelore Islame” i plotëson kriteret e standarteve të mësipërme si një program MSc; sidoqoftë me riorganizimin e tij dhe emërtimin “Shkenca Islame” sugjerohet edhe rishikimi i lëndëve, që do i japin fizionominë në përputhje me emërtimin e ri dhe do bëjnë diferencimin nga programi tjetër MSc në “Shkenca Moderne Islame”.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit MSc në “Shkenca Themelore Islame” realizohet pranë Departamentit të Shkencave Islame, një nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane pjesë përbërëse, së bashku me Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit të KUB.. Në përbërje të tyre janë gjithsej 6 departamente si dhe dy qendra kërkimore zhvillimore e njësitë ndihmëse administrative.

Fakulteti i Shkencave Humane ka në përbërjen e vet Departamentin e Shkencave Islame, Departamentin e Drejtësisë dhe Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Fakulteti bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimdhënëse-kërkimore. Fakulteti ofron programe të studimeve “Bachelor” dhe “Master i Shkencave”, në përfundim të të cilave jepet diplomë. Si njësi kryesore, fakulteti operon në bazë të parimit të autonomisë, brenda kompetencave përkatëse. Në Fakultetin e Shkencave Humane, pranë departamentit të Shkencave Islame, studentët kualifikohen në fushën e Shkencave Islame, duke u përgatitur me njohuri të nivelit bashkëkohor. Studimet e ciklit të dytë u krijojnë mundësinë për studime të thelluara brenda dhe jashtë vendit. Njësia, me programet Bachelor dhe MSc, bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe angazhimin social e ndërkulturor.

Në vizionin e vet, Fakulteti i Shkencave Humane synon të japë përvojën dhe risitë në mënyrën e aftësisë dhe të përgatitjes së studentëve, nëpërmjet gërshetimit të mirorganizuar të anës teorike me atë praktike, me një staf akademik të kualifikuar dhe në kushtet e një infrastrukture mësimore e kërkimore bashkëkohore.

Si njësi bazë, Departamenti i Shkencave Islame ka në përbërjen e vet stafin akademik, Këshillin e Departamentit dhe Sekretarinë mësimore përkatëse.

Këshilli i departamentit kryesohet nga përgjegjësi i departamentit dhe përbëhet nga zëvendësit e tij, nëse ka, dhe nga anëtarët e stafit akademik të departamentit. Këshilli merr vendime në lidhje me transferimet e studimeve dhe bën njohjen e lëndëve dhe programeve mësimore duke ia dërguar dekanatit për dijeni.

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Islame është një staf i kualifikuar, kryesisht me grada e tituj shkencor. Departamenti, për natyrën e tij specifike si dhe mungesën e personelit të përgatitur akademik para hapjes së institucionit në fushën e shkencave islame, për shkaqet e njohura të mungesës së ushtrimit të lirisë së besimit islam në Shqipëri për një periudhë të gjatë, është hapur e ka funksionuar duke punësuar personel akademik vendas dhe të huaj. Gjithashtu gjuha e zhvillimit të programit është turqishtja, në pritje të miratimit të organizimit të departamentit në gjuhën shqipe. Aktualisht Departamenti ka 14 pedagogë, 11 të brendshëm dhe tre të jashtë, Nga këta anëtarë, 1 është me titullin Prof. Asoc, 5 me gradën Dr. (njëri i jashtëm), 3 në proces doktoreture (një i jashtëm) dhe 5 MSc (një i jashtëm) Çdo departament zgjedh Komitetin shkencor për çdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës të ciklit të dytë, përcakton personelin tjetër akademik dhe ndihmës, me të cilin do të bashkëpunojë për realizimin e programit të studimit, përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve dhe programin e kërkimeve. Komiteti përgatit çdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. Komiteti ka në përbërje tre antarë, me tituj e grada shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Përsa i përket stafit akademik të Departamentit, duke filluar nga viti akademik 2013-2014 e deri në vitin aktual akademik 2018-2019, lidhur me PAE (personel akademik efektiv), ka një rritje të stafit me tituj e grada shkencore. Në vitin akademik 2013-14 personeli me grada e tituj shkencore për bënte 1/3 e të gjithë stafit akademik, ndërsa për vitin 2018-2019 stafi me tituj e grada shkencore përbën 1/2 e të gjithë stafit akademik. Ndërkaq, vihet re një ulje e numrit të PAK (personel akademik efektiv), cka do të thotë se është rritur pesha në mësimdhënie nga ana e PAE.

(Shih në aneks tabelat 1, 2)

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>KUB organizohet në mbështetje të kuadrit ligjor që e përcakton atë si kolegji universitar. (Vendimi i Keshillit të Ministrave për licencimin e Shkolles së Lartë “Hena e Plote” Beder, evid.nr.14, Statuti (evid. nr.1) dhe Rregullorja Themelore e institucionit.(evid.nr.2). Institucioni ofron studime në dy cikle, në ciklin e parë (Bachelor) dhe në ciklin e dytë (MSc). Ky organizim përputhet me synimin që KUB ka për përmbushjen e misionit të vet, si IAL.</p> <p>KUB përbëhet nga dy fakultete, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit.</p> <p>Sipas Statutit, Rregullores Themelore e RVB, Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga 3 departamente:</p> <p>Departamenti i Drejtësisë Departamenti i Shkencave të Komunikimit Departamenti i Shkencave Islame</p> <p>Ndërsa Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit përbëhet po nga 3 departamente:</p> <p>Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze Departamenti i Shkencave të Edukimit Departamenti i Shkencave Kompjuterike</p> <p>Sipas Statutit, Rregullores Themelore e RVB, fakultetet janë të përbërë nga tre departamente, me objektiva të përcaktuara qartë në dokumentacionin përkatës, të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të tij. Rezulton se Departamenti i Shkencave Islame drejtohet nga Këshilli i Departamentit, ku përfshihet i gjithë stafi akademik i brendshëm. Në përbërje të departamentit përfshihet përgjegjësi i Departamentit, 11 pedagogë me kohë të plotë, 3 pedagogë me kohë të pjesshme. Në përbërje të stafit, janë; 1 anëtar efektiv me gradën shkencore “Prof. Assoc. Dr”, 4 anëtarë efektivë me gradën shkencore “Doktor” dhe 6 anëtarë me gradën Msc.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Bazuar në Statut, neni 4, 5, në Rregulloren Themelore, neni 25 si edhe në Rregulloren e Organizimit Akademik (evid.nr.3), stafi i fakultetit dhe i departamentit duhet të përmbushin me përgjegjësi detyrimet që kanë për realizimin e programeve të studimeve. Edhe në objektivat e shpallura, misionin dhe vizionin përkatës, si të njësisë kryesore (fakultetit), ashtu edhe njësisë bazë (departamentit), reflektohet përgjegjshmëria për realizimin e programeve të studimit.. (Model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr.20; model i raportit institucional vjetor, evid.nr.34)</p> <p>Si njësia kryesore, edhe ajo bazë përfshihen në procedurën e</p>

	<p>rekrutimit të personelit akademik, në bazë të Rregullores për Punësimin, Promovimin dhe Vlerësimin e Performancës Akademike (evid.nr.7). Departamenti, si njësi bazë dhe përgjegjës për organizimin e programit të studimit, identifikon nevojat për staf të ri akademik. Kërkesa i dorëzohet për aprovim dekanit të Fakultetit e më pas rektorit. Pas miratimit, kërkesa i dërgohet për ndjekje Zyres së Burimeve Njerëzore, që ka për detyrë të publikojë vendin (vendet) vakant në web-in e KUB dhe/ose në zyrën e punës. Në bazë të kriterëve të vendosura, Zyra e Burimeve Njerëzore bën seleksionimin e parë dhe me pas dosja (dosjet) që plotëson kriteret formale i shkon për shqyrtim komisionit ad-hoc të vlerësimit, të ngritur nga njësi bazë, të përbërë nga Dekani i fakultetit përkatës, përgjegjësi i Njesisë bazë përkatëse, si dhe një anëtar nga personeli akademik i njesisë bazë, relator i komisionit. Komisioni bën renditjen e kandidatëve dhe ia propozon rektorit për miratim, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Rektori bën miratimin e vendimit që i dërgohet për ndjekje Zyrës së Burimeve Njerëzore, që informon, më tej, të gjithë stafin, nëpërmjet e-mail mbi emërimin e ri.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga studimi i RVB, hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) si dhe nga të dhënat gjatë vizitës në institucion dhe takimet me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Islame dhe stafin akademik, njësitë administrative përkatëse dhe, në bazë të analizës së dokumentacionit që i referohet kriterëve të mësipërme, mund të evidentohen përfundimet e mëposhtme:

- a. Institucioni është i organizuar e vepron në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përmbushje të misionit të tij. Institucioni përmbush kriterin e dy fakulteteve dhe organizimin në tre njësi bazë, të cilat kanë të përcaktuar qartë misionin dhe objektivat e tyre.
- b. Departamenti i Shkencave Islame i plotëson kriteret ligjore të përbërjes së stafit akademik, sipas titujve dhe gradave shkencore.
- c. Konstatohet se njësitë kryesore dhe njësitë bazë të institucionit janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë në organizimin e programeve të studimit.
- d. Institucioni realizon një procedurë të rregullt e transparente për rekrutimin e vlerësimin e personelit akademik, që mbështetet në rregulloren përkatëse.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Periudha pas akreditimit të parë, në vitin 2013 nga APAAL, i programeve të ciklit të parë e të dytë të Departamentit të Shkencave Islame, karakterizohet nga rritje sasiore dhe cilësore e stafit akademik.




Duke krahasuar dokumentacionin me të dhëna për personelin akademik të departamentit dhe, në vecanti, të programeve MSc gjatë periudhës 6-vjecare 2013-2019 ,(RVB, Raporti vjetor i Departamentit. 2017-2018, evid. nr. 20, lista me CV-të e stafit akademik, evid.nr.40,etj) rezulton se, për shkak të mungesës së një stafi të kualifikuar shqiptar, në fillim të veprimtarisë, për natyrën specifike të Departamentit si i vetmi në fushën e Shkencave Islame, mësimdhënia është realizuar nga një personel akademik i huaj, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, me tituj e grada shkencore, në përputhje me statutin e KUB e rregulloren “Mbi organizimin akademik” (evid.nr 3). Në dinamikën e zhvillimit të departamentit, me rekrutimin e kualifikimin progresiv të stafit shqiptar, si dhe në kushte të mobilitetit të një pjese të stafit të huaj, fillon të rritet përbërja e tij me staf akademik shqiptar. Duke filluar nga viti akademik 2016-2017, departamenti ka një përbërje të konsiderueshme të stafit të ri shqiptar, në të gjitha programet që realizon. Sipas raportit vjetor të Departamentit 2017-2018, nga 15 pjestarë të stafit akademik të departamentit, 11 janë me kombësi shqiptare, midis të cilëve 1 nga Kosova, 3 nga Turqia dhe 1 lektor nga Jordania. Përgjegjësi i departamentit është vendas, me gradën “Dr” dhe, nga sa rezulton nga CV-ja, me një veprimtari të gjërë botuese e kerkimore-shkencore. Lidhur me programin MSc “Shkenca Themelore Islame”, sic del nga shqyrtimi i të dhënave të RVB, rubrika 4, në vitet akademike 2013-14; 2014-15, 2015-16, përbërja e stafit ka qënë e gjitha e huaj; në këtë staf efektiv, një ka pasur titullin “Prof. Dr” dhe pjesa tjetër gradën “Dr”. Me lëvizjen e stafit të huaj dhe kualifikimin e stafit shqiptar, duke filluar nga viti akademik 2016-17 dhe në vazhdim, programi është mbuluar, në një pjesë të stafit, edhe me personel shqiptar, ku titulli më i lartë është “Prof. Asoc”, ndërsa pjesa tjetër, si e stafit efektiv, ashtu edhe me kontratë (staf shqiptar) ka gradën “Dr”. Mungesa e lektorëve shqiptarë me tituj shkencorë është e justifikuar, po të mbahet parasysh jetëgjatësia e shkurtër e departamentit dhe specifika e tij.

Nga takimi me Dekanin e Fakultetit, përgjegjësin e departamentit të Shkencave Islame, përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe nga njohja me procedurat e rekrutimit, bazuar në “Rregulloren për Punësimin, Promovimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit” (evid nr. 5) si dhe dosjet e stafit akademik dhe atij mbështetës, rezulton se departamenti, në kuadër të institucionit, zhvillon një politikë transparente rekrutimi, në përputhje me rregulloren, si për stafin me kohë të plotë, ashtu edhe atë me kohë të pjesshme. (Procedura e punësimit të stafit, evid. Nr. 10; Model i kontratës për stafin akademik,evid. Nr. 11; Praktika e ndjekur për rekrutimin e stafit, evid.nr.35). Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se është aplikuar një procedurë e rregullt e transparente edhe për punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe të atij administrativ. Sipas të dhënave nga takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, institucioni ndjek politika të rekrutimit të stafit nga të diplomuarit e vetë institucionit; për këtë qëllim studentë të programit të ciklit të dytë bëjnë praktikën pranë kësaj zyre, për punësimin e tyre në të ardhmen në njësitë administrative të institucionit. Rregulloret përkatëse të organizimit akademik dhe atij administrativ (evid.nr 3 dhe nr.4) përcaktojnë detyrat dhe funksionet e organeve akademike si dhe kushtet e punësimit, përgjegjësitë dhe kompetencat e stafit administrativ.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit

(Tabela 2 në aneks)

Sipas të dhënave nga RVB, për programin e studimit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, personeli efektiv PAE dhe ai me kontratë PAK, ka qënë respektivisht:

1. Viti akademik 2013-14: 5 (1 “Prof.” + 3 “Dr”):1 (“Prof”);
2. Viti akademik 2014-15: 5 (1 “Prof.”+ 4 “Dr”)
3. Viti akademik 2015-16 : 6 (1 “Prof.”+ 4 “Dr”):1(“Dr”),
4. Viti akademik 2016-17: 5(1 “Prof.”+ 4 “Dr”)
5. Viti akademik 2017-18 : 7 (5 “Dr”) : 2 (“Dr”)
6. Viti akademik 2018-19 : 5 (4“Dr”):1(“Dr”).

Në tërësi, personeli i programit “Shkenca Themelore Islame” i zotëron gradat e titujt e nevojshëm për mësimdhënie, sipas Rregullores. Rezulton gjithashtu se, në periudhën 6-vjecare pas akreditimit të parë,

duke gjykuar nga raporti i PAE me PAK, programi është mbuluar nga stafi i brendshëm, respektivisht, për vitin akademik 2013-14 në masën 75%; për vitin akademik 2014-15, 100 %; për vitin akademik 2015-16, 80%; për vitin 2016-17, 100% dhe për vitin aktual 2018-19 në masën 75%. (sipas tab. 4 dhe tab.5 në aneks). Në vitin akademik 2017-18 nuk rezultojnë studentë për këtë master (sipas tab. 17 në aneks).

Lidhur me ngarkesën mësimore të stafit akademik me kohë të plotë, sipas raportit: ngarkesë në programin master : ngarkesë në total në department, ajo rezulton përkatësisht: Dr. G.K (përgj. Dep).322:434; Dr. A.K 350:418; Dr. J. A.98: 210; Dr. A.D 154:266; Dr. F.U.B 266 :321; Dr. N. Ç 28 :28; Dr. H.B (me kontratë) 196: 224. Ndersa ngarkesa per vitin aktual akademik 2018-2019 rezulton si vijon: Dr. G.K (përgj. Dep).294:476; Dr. J. A.168:448; Dr. A.D 294:434; Dr. F.U.B 182 :336; Dr. H.B (me kontratë) 224:294, (Ngarkesa e orëve mësimore të stafit, evid.shtesë.nr.1).

Bazuar tek Udhëzimi: “Për ngarkesën mësimore” (evid.nr. 9), ku përcaktohen kriteret e përlllogaritjes së ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm të angazhuar në mësimdhënie në programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në KUB e sipas të cilës pergjegjesi i departamentit duhet të ketë 170/60 orë mësimore e lektori 260 orë mësimore, gjykojmë se vecanërisht një pjese e stafit rezulton ta ketë të lartë, sa dyfishi i normës (përgj.depart, e disa lektorë). Ndërkaq, po sipas këtij udhëzimi, anëtarit të stafit akademik nuk mund t'i paguhen më shumë se 20 orë shtesë mësimore. Ka gjithashtu anëtarë të tjerë me një ngarkesë minimale (28:28), ndërsa i ngarkuar rezulton edhe lektori me kohë të pjesëshme (196:224). Kjo mund të lidhet edhe me faktin se lektorët më të kualifikuar, mbulojnë lëndët njëkohësisht të dy programeve MSc; mendojmë se kjo ngarkesë do zbutet me përgatitjen e shtimin e personelit akademik me grada e tituj shkencorë.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

(Tabela 3 në aneks)

Lidhur me përbërjen e Këshillit Shkencor të programit të studimit, nga tabela rezulton se, nga viti akademik 2013-2014 e në vijim, duke përfshirë edhe vitin akademik 2016-2017, Këshilli shkencor dhe koordinatorët e programit të studimit ishin shtetas të huaj, me titujt përkatës të duhur për këtë funksion. Në dy vitet e fundit akademike (2017-2018 dhe 2018-2019), në përbërje të Këshillit ka edhe staf shqiptar, me tituj shkencorë.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

(Tabela 5 në aneks)

Përsa i takon kualifikimit, bazuar në tabelën përkatëse, rezulton se në tre vitet e para të periudhës 6 vjecare 2013-2019 të veprimtarisë së departamentit, kur ende ishte i papërgatitur stafi shqiptar, programi është mbuluar me staf të huaj, kryesisht me gradën “Dr” dhe një “Prof”. Duke filluar me vitin akademik 2016-17 e në vijim, vihet re shtimi progresiv i stafit akademik shqiptar me gradën “Doktor”. Për vitin akademik 2018-19 në përbërje të stafit shqiptar është edhe një “Prof. Asoc”.

Të dhënat sipas seksit

Nga verifikimet e dokumentacionit, Tabela 1 në aneks me Listën e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve, rezulton se nga viti akademik 2013-14 dhe deri në vitin akademik 2017-18 (i përfshirë), nuk ka pasur në përbërje të stafit asnjë anëtar të seksit femër. Vetëm për vitin aktual akademik 2018-19, është rekrutuar, në përbërjen e stafit akademik, një vajzë e diplomuar në departamentin e Shkencave Islame, MSc, si asistente lektore. Ndërkaq, nga njohja me listën e studentëve të diplomuar në ciklin e dytë MSc në “Shkenca Themelore Islame” (dok. “Lista e të diplomuarve në programin MSc në “Shkenca Themelore Islame”, evid. 28 dhe “Lista e studentëve aktive në programin MSc në “Shkenca Themelore Islame”, evid. Shtesë. nr 5) rezulton se ka edhe vajza të diplomuara, në një numër më të vogël nga programi tjetër MSc, por që në total, nga të dyja programet. rezultojnë në një masë të konsiderueshme dhe me rezultate të kënaqëshme “(Modeli i raportit vjetor të departamentit”, evid.nr.20). Duke krahasuar, nga Tabela 2 në aneks, Listën e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve, rezulton se, në përbërje të personelit akademik të dy departamenteve të tjera të Fakultetit të Shkencave Humane, ka përbërje të konsiderueshme të gjinisë

femërore. Jemi të mendimit se, në të ardhmen, në departamentin e Shkencave Islame, duhet të shihet me përparësi politika e rekrutimit të stafit të ri, edhe sipas kriterit gjinor.

Të dhëna sipas moshës së personelit

(Tabela 6 në aneks)

Shpjeguar me historinë e natyrën specifike të Departamentit të Shkencave Islame, rezulton se, lidhur me përbërjen moshore, përqindjen më të madhe në përbërje të stafit e zë grupmosha 36-45, ndërsa stafi i grupmoshës 25-35 është ende në proces kualifikimi.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga takimet që GVJ bëri në Dekanin e Fakultetit, me përgjegjësin e departamentit, në Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe nga shqyrtimi i dosjeve të stafit e procedurave të rekrutimit të tij, rezulton se kontratat e punës që nënshkruhen në KUB dhe, në rastin konkret, ato që lidhen me personelin akademik të Departamenti të Shkencave Islame, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Shih nenin 61 të Statutit të KUB, evid.nr. 1, Rregulloren Themelore të KUB, neni 26, 27, evid.nr.2; Modelin e kontratës së punës për stafin akademik, evid.nr 7, Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e stafit akademik, evid. 10, Procedurë për punësimin e stafit, evid. Nr.18, Praktika e ndjekur për rekrutimin e stafit akademik, evid. Nr. 35). Sipas të gjitha dokumentave, procesi i rekrutimit i nënshtrohet të gjitha fazave të përcaktuara nga këto dokumenta dhe është transparent. Kontrata e punës mund të jetë me afat dhe/ose pa-afat në bazë të kategorisë së stafit akademik dhe kohës së punësimit të tij pranë KUB, në përputhje me rregulloren. Po kështu, të drejtat e detyrat sipas kategorisë së punës për stafin akademik janë të gjitha të përcaktuara qartë në dokumentat e mësipërme (statut e rregullore), bazuar në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë. Proces i vlerësimit, qoftë institucional, ashtu edhe i vetëvlerësimit të cilat, rezultojnë se aplikohen në mënyrë sistematike dhe rigoroze, janë indikatorë të tjerë që tregojnë nivelin e zbatimit të të drejtave, detyrave e përgjegjësi të stafit akademik në institucion.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë.

Nga njohja me dokumentacionin përkatës (Statuti i KUB evid.nr 1, Rregullorja Themelore e Kub, evid. Nr 2, Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit, evid. Nr. 7, Rregullorja mbi organizimin administrativ, Evid. Nr.4), dosje të personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe nga takimet në dekanat, me përgjegjësin e departamentit e përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se personeli ndihmës/ administrativ plotëson kriteret ligjore të rekrutimit. Personeli administrativ, ashtu sic përcaktohet në rregulloren e organizimit administrativ, emërohet në detyrë nga Administratori i institucionit. Përzgjedhja bëhet nga një komision i përbërë nga administratori i institucionit, përgjegjësi i zyrës së Burimeve Njerëzore (i cili është dhe relatori i komisionit) si dhe përgjegjësi i zyrës përkatëse. Komisioni analizon përputhjen e aplikimit me vendin e lirë të punës, përzgjedh kandidaturën e përshtatshme në bazë të dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar dhe ia kalon për miratim administratorit të KUB, që nënshkruan kontratën e punës. Personeli i ri i rekrutuar, për tre muaj ka statusin e personelit në prove, gjatë të cilës, nëse nuk përshtatet me detyrën e ngarkuar, i ndërpriten marrëdhëniet e punës. Me përfundimin me sukses të periudhës së provës, personelit të rekrutuar i caktohet detyra përkatëse.

Në administratën e departamentit, nga sa rezulton në dosjet e shqyrtuara të personelit, janë rekrutuar individë me kualifikimet e duhura, një pjesë edhe jashtë shtetit (p.sh përgjegjësi e Zyrës së Burimeve Njerëzore, etj). Stafi i nënshtrohet periodikisht edhe një procesi trainimi institucional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Nga vlerësimi i dosjeve të personelit dhe të dhënave mbi arsimimin dhe kualifikimin e stafëve (CV-të e stafit akademik, Lista e plotë sylabuseve të programit MSc në Shkenca Themelore Islame, evid. Nr.27, etj), rezulton se angazhimi i tyre është në përputhshmëri me detyrat e objektivat e programit. Për programin MSc në Shkencat Themelore Islame, nga shqyrtimi edhe i dokumentacionit (Praktika e ndjekur për rekrutimin e stafit akademik, evid.shtese. nr. 4, Formular vlerësimi për projektet e kërkimit shkencor, evid. shtesë.nr 8, , lista e të dhënave individuale të personelit më kohë të plotë e të pjesëshme, evid. shtesë. Nr 10 e 11, etj) rezulton se nga ana e departamentit ka përgjegjësi që personeli akademik që mbulon programin të ketë kualifikimet e duhura si dhe veprimtari botuese e kërkimore shkencore, në përputhje me fushën e mësimdhënies .</p> <p>Nga takimet e GVJ në departamentin e Shkencave Islame me personel akademik si dhe ndihmës mësimor-shkencor e administrativ si dhe nga njohja me praktikën e punës së tyre në veprimtarinë mësimdhënëse, te kërkimit shkencor, administrativ etj (model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr.20; Lista e trainimeve të stafit. evid.nr.30; lista e publikimeve e projekteve, evid.nr.31; Aktiviteti akademik i departamentit, evid. Nr.34), rezulton se në institucion ka angazhim e përgjegjësi në zbatimin e detyrave, në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat strategjike për zhvillimin e institucionit (të paraqitura qartë edhe në planin strategjik 2018-2023, evid.nr.13), janë të njohura dhe të orientuara sepse, që nga viti 2014, departamenti ka krijuar një praktike pune pozitive të trainimeve, kryesisht në fillimet e vitit akademik, por edhe gjatë tij, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe NJSBC-në (lista e trainimeve të personelit akademik dhe administrativ. evid.nr.30) Sic rezulton edhe nga tematika e trainimeve, që kanë si target grup si personelin akademik, ashtu edhe atë administrativ, trainimet janë orientuar në trajtimin e çështjeve që lidhen me rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me në qëndër studentin me mendim kritik, të argumentuar e inovator; përgatitjen më cilësore për tregun e punës e nevojat e shoqërisë; aftësimin në shkrimin e projekteve e nxitjen e kërkimit shkencor; forcimin e frymës së përgjegjesisë sociale të të gjithë aktorëve në institucion; qëndrueshmërinë institucionale; rolin e administratës e njësisve të saj në rritjen e efektivitetit të punës në institucion; probleme të përditësimit të sylabuseve; probleme të kuptimit e zbatimit të planit strategjik dhe zhvillimit institucional, të etikës e komunikimit në administratë, etj. Kjo tematikë e pasur është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e objektiveve strategjike të institucionit e zhvillimit të tij të qëndrueshëm (Plani strategjik i KUB 2018-2023, evid.nr.13)</p> <p>Sipas RVB, anëtarë të Departamentit kanë marrë pjesë në grupet e punës për përgatitjen e planit strategjik të institucionit.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p>	<p>Sipas të dhënave nga takimi i GVJ me stafin akademik të Departamentit të Shkencave Islame konfirmohet se personeli akademik luan rolin kryesor për hartimin e kurrikulës së programit MSc e</p>

<p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>vendimeve që lidhen me organizimin e programit, mbi bazën e ekspertizës e përgjegjësisë së secilit si dhe diskutimeve kolegjiale në departament.</p> <p>Rol të rëndësishëm në përgatitjen e personelit akademik luajnë trainimet që kanë në fokus këtë problematikë (lista e trainimeve të personelit akademik dhe administrativ. evid.nr.30)</p> <p>Nga takimet e GVJ në dekanat, në departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore, si dhe nga njohja me praktikën e punës, bazuar në dokumentacionin përkatës (Udhëzim “Për ngarkesën mësimore” evid.nr.9, procedura e punësimit të stafit, evid. Nr.10, Model I kontratës për stafin akademik, evid.nr.11), rezulton se ngarkesa mësimore e stafit akademik në Departamentin e Shkencave Islame, përcaktohet në përputhje me marrëveshjet e punësimit dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sic rezulton edhe nga shqyrtimi i CV të pedagogëve dhe ngarkesës në lëndët përkatëse mësimore (Lista e të dhënave individuale të personelit. Evid.nr 10,11), në miratimin e ngarkesës mësimore është marrë parasysh profili, përgatitja dhe eksperiencia përkatëse e tyre, si dhe angazhimi administrativ. <i>Sidoqoftë, në ndonjë rast të vecantë, ngarkesa mësimore e tejkalon normën (Dok: Ngarkesa e orëve mësimore të stafit. Evidenca shtese. Nr.1)</i></p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që i referohet rregullave dhe procedurës së rekrutimit të stafit në institucion (Statuti i KUB, evid.nr.1.neni 61, : Rregullorja Themelore e KUB, evid.nr.2, neni26, Procedura e rekrutimit të stafit, evid.nr.10), nga takimet në departament e Zyrën e Burimeve Njerëzore, konstatohet se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit ,në përputhje me statutin dhe rregulloren.</p> <p>Sipas nenin 61 të Statutit, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga Departamenti, mbi bazën e nevojave përkatëse, pas pëlqimit të dekanit dhe miratimit nga rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga njësia bazë përkatëse. Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit.</p> <p>Bazuar në RVB e tabelat përkatëse mbi gradat e titujt shkencorë të stafit akademik të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” si dhe raportin PAE:PAK (sipas tab.4 dhe tab.5 në aneks), rezulton se stafi me kohë të plotë, me tituj e grada shkencore, përgjatë periudhës 6 vjecare pas akreditimit të parë, ka përbërë mbi 75% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të këtij masteri shkencor. Nga takimet e GVB me stafin e Departamentit të Shkencave Islame, me studentë, përfaqësues të NJSBC si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës (Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve evid.nr.6; Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit, evid.nr.7; Formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik, evid.nr.18; Anketa e vlerësimit për</p>

lëndën e pedagogut nga studentët, evid.nr.26; Formulari i vlerësimit për projekte të kërkimit shkencor, evid.shtesë nr.8, RVB, etj) konstatohet se në institucion ka një sistem të institucionalizuar dhe transparent të vlerësimit të personelit. Ky vlerësim përmban disa komponentë, si: vlerësimin nga ana e studentëve për lektorët e lëndëve, vetëvlerësimin, dhe vlerësimin e përgjegjësit të departamentit për secilin nga anëtarët e stafit. Vlerësimi i studentëve për lektorët e lëndëve është i rregullt dhe bëhet, nëpërmjet anketimit, në fund të çdo semestri para provimeve finale. Studentët vlerësojnë indikatorët e detajuar që lidhen me performancën e pedagogut dhe rezultatet përpunohen elektronikisht. Cdo pedagog plotëson edhe një formular vetëvlerësimi, me indikatorë përkatës në fund të vitit akademik, dhe procedura vazhdon më tej me shqyrtimin e vlerësimit nga ana e përgjegjësit të departamentit mbi vetëdeklarimet e personelit dhe rezultatin e arritur. Nga takimi që GVJ pati në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit dhe njohja me dosjet e procedurën e rekrutimit të personelit, rezulton se institucioni mban një bazë të dhënash mbi personelin, të cilat përditësohen me ndryshimet e progresin e veprimtarisë akademike respektive. Bazuar tek Statuti dhe Rregullorja themelore e KUB, në Departamentin e Shkencave Islame ndiqet procedura e parashikuar për rekrutimin e stafit (Praktika e ndjekur për rekrutimin e stafit akademik, evid.nr. 4; Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit, evid.nr.7;) Njoftimet për vende të lira pune bëhen transparente, në faqen e internetit të institucionit, në mediat sociale, në Drejtorinë Rajonale të Punësimit. Zyra e Burimeve Njerëzore mban të dhëna mbi njoftimet e punësimit e kërkesat për staf të ri akademik që vjen nga ana e departamentit si dhe dosjet e stafit të punësuar.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron

Sipas Statutit të KUB (evid.nr.1), neni 45, ku përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë kandidati për përgjegjës departamenti, në përputhje me këtë nen, përgjegjësi aktual i departamentit të Shkencave Islame, mban titullin shkencor “Doktor”. Në vitet e para pas akreditimit, kur stafi i kualifikuar ishte kryesisht i huaj, përgjegjësit ishin të huaj, me tituj “Prof” ose “Dr”; duke filluar nga viti akademik 2016-17, në kushtet e mobilitetit të një pjese të stafit të huaj dhe kualifikimit të stafit të ri shqiptar, përgjegjësi i departamentit mban gradën shkencore “Doktor” dhe ka një CV të pasur të punës mësimore,-kërkimore, shkencore e botuese.

Nga të dhënat e listës së sylabuseve të programit MSc “Shkenca Themelore Islame”(evid. Nr.27), CV e stafit akademik të programit MSc “Shkenca Themelore Islame” (evid.nr 40) si dhe të dhënat nga RVB, rezulton se lëndët/modulet e programit mbulohen tërësisht nga titullarë me gradën shkencore “Doktor”. në përputhje edhe me Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, evid.nr.5. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Shkencave Islame, nuk ofron program *Master Profesional*.

Sipas Zyrës së Burimeve Njerëzore, në përputhje me Modelin e

<p>programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>kontratës për stafin akademik” (evid.nr.11), në kontratat e tyre të punës, titullarët e institucionit (rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, etj) figurojnë si të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Programi “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, në kurrikulën e tij nuk parashikon praktikë profesionale.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga takimet që GVJ bëri në departament me përgjegjësin dhe stafin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” si dhe nga dokumentacioni që rregullon procedurën e udhëheqjes së tezës (Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë , evid.nr.5) konstatohet se studentët e këtij programi kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës, në përfundim të studimeve të këtij cikli. Studenti fillimisht paraqet kërkesën pranë departamentit, që, pasi vlerësohet, dërgohet në dekanat për miratim. Aprovohet, sipas kriterit të udhëheqjes së temës nga pedagog (udhëheqës), ekspert i fushës, në përputhje me rregulloren e sipërcituar. Udhëheqësi ka për detyrë të mbikëqyrë e drejtojë studentin në punën kërkimore dhe përgatitjen e tezës.</p> <p>Nga takimet në Departamentin e Shkencave Islame me stafin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” dhe nga të dhënat e RVB, rezulton se, në kushtet e një numri relativisht të vogël të studentëve diplomantë të këtij programi si dhe të stafit të programit që zotëron gradën shkencore “Doktor”, përmbushen kushtet që udhëheqja e tezave të mbulohet nga stafi akademik i programit, në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë të KUB, evid.nr 5.</p> <p>Nga takimet me stafin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” dhe nga RVB, rezulton se në këtë program është zbatuar Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Dytë, që përcakton se në fushën e shkencave shoqërore e humane, udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më tepër se 10 studentë. Për shkak të numrit relativisht të vogël të studentëve diplomantë në këtë program, në të gjitha vitet akademike të funksionimit të tij, udhëheqësi nuk ka drejtuar më shumë se 5 studentë në përgatitjen e tezës.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, nga shqyrtimi i CV-ve të stafit që mbulon këtë program (evid.nr.40), sylabuseve të programit (evid.nr.27), të dhënave të RVB-së, rezulton se përgjithësisht, stafi që mbulon programin MSc në “Shkenca Themelore Islame”, ka formimin e specializimit përkatës, që përputhet me fushat studimore të programit. Kjo jep mundësi që edhe në udhëheqjen e temës, nga fusha e studimeve përkatëse, udhëheqësi të ketë ekspertizën e duhur.</p> <p>Nga takimi me stafin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” si dhe të dhënave të RVB-së, rezulton se caktimi i udhëheqësit që drejton përgatitjen e tezës së studentit master bazohet në përgatitjen e tij të posacme, me njohuri të thelluara teorike dhe eksperiencë</p>

	<p>kërkimore në fushën përkatëse (të tematikës që trajton teza), sipas Rregullores së Studimeve të Ciklit të Dytë. Lidhur me caktimin e tezës, zbatohet procedura e plotësimit nga studenti master e një formulari të posaçëm me titullin e propozuar të tezës dhe e caktimit të udhëheqësit përkatës. Këto propozime paraqiten në Dekanat, ku bëhet miratimi përkatës. Sidoqoftë është departamenti që, nisur nga preferencat e studentëve dhe ekspertizën e anëtarëve të stafit, bën rishpërndarjen e udhëheqësve, sipas fushës së tyre të specializimit, që përkon edhe me fushën e tyre të mësimdhënies. Procedura i përmbahet Rregullores përkatëse të Studimeve të Ciklit të Dytë në MSc në “Shkenca Themelore Islame”.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga takimet e GVJ në departament, vizitat në mjediset e institucionit, dëshmohet se personeli ndihmës mësimor-shkencor i përgjigjet detyrimit për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB me të dhënat përkatëse (tabelat) mbi planet mësimore të Departamentit të Shkencave Islame të lidhura me personelin akademik përkatës, përfshirë edhe të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, nga viti akademik 2013-2014 në vijimësi deri në vitin e tanishëm akademik 2018-2019, por edhe nga të dhënat e raportit vjetor të departamentit (evid.nr.20) e atij institucional (evid.nr.34) rezulton se departamenti mbështetet, në përmbushjen e objektivave të programeve, pra edhe të programit MSc, në një personel që zotëron titujt e gradat e nevojshme shkencore, sipas standarteve ligjore. Në përbërje të stafit akademik me kohë të plotë janë: 1 Prof. Asoc, 4 “Dr” dhe 6 “Msc”. Gjithashtu Departamenti ka angazhuar me kontratë lektorë me tituj shkencorë e specialistë të fushës që mbulojnë në mësimdhënie. Është rritur, gjatë periudhës nga akreditimi i parë, numri i personelit akademik shqiptar si dhe kualifikimet e stafit me moshë të re.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik (Udhëzim “Për ngarkesën mësimore”.evid. nr. 9) dhe nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore të stafit akademik të programit MSc në vecanti sipas evid. shtesë.nr.1: “Ngarkesa e orëve mësimore të stafit”, rezulton se përgjithësisht, stafi i lektorëve e realizon ngarkesën në bazë të udhëzimit përkatës. <i>Sidoqoftë, në ndonjë rast, ka edhe kapërcim të normës. psh përgjegjësi i departamentit rezulton, për vitin 2017-18 me ngarkesë prej 322 orësh në programin MSc dhe 434 orë mësimore gjithsej, ndonëse ka normë të përcaktuar më e ulët, për shkak të angazhimit administrativ. Po kështu edhe në një rast tjetër, lektori ka 350 orë në programin MSc dhe 418 gjithsej.</i></p> <p>Në udhëzimin e rektoratit të KUB “Për ngarkesën mësimore”, evid.nr.9.neni.2, përcaktohet ngarkesa mësimore e personelit akademik, përfshirë edhe programet e studimeve të ciklit të dytë, me orë mësimore. Për programin MSc në “Shkenca Themelore Islame”, evid. shtesë.nr.1: “Ngarkesa e orëve mësimore të stafit” pasqyrohet</p>

	konkretisht ngarkesa mësimore e lektorëve, e vlerësuar me orë mësimore.
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>GVJ,bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, me CV të detajuara dhe të përditësuara si dhe të dokumentacionit pranë departamentit (lista e të dhënave individuale të personeli me kohë të plotë evid. Shtesë.nr10, nr 11; emrat e stafit pjesmarrës në trainime, evid.shtesë.nr 16; lista e sylabuseev të programit evid.nr 27; lista e publikimeve dhe projekteve të stafit, evid. Nr.31, aktivitetet akademike te departamentit të shkencave Islame, evid.nr.34, shembull I formularit të vlerësimit të stafit evid shtese. Nr.6, formular vlerësimi për projekte të kërkimit shkencor, evid.shtesë.nr.8, etj), konstaton se institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për stafin e programit të studimit, në vecanti, e të gjitha programeve në përgjithësi. Në raportin vjetor të departamentit (model i raportit vjetor të depart.evid.nr.20) bëhet referimi për aktivitetet, performancën e stafit në mësimdhënie e kërkim shkencor, problematika të ndryshme të lidhura me programet, etj</p> <p>Dokumentacioni i cituar më sipër vërteton se Institucioni disponon një listë të plotë të stafit akademik, ndihmës mësimor-shkencor e administrativ, ngarkesën e tyre mësimore, sipas semestrave. Vec kësaj, institucioni, sipas edhe RVB, ka si detyrim ligjor ndaj MASR që në fillim të çdo viti, të përgatisë dhe dorëzojë listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrative.</p> <p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kriteret përkatëse përmbahet në një sërë dokumentash të institucionit. Udhëzimi “Për ngarkesën mësimore”.evid.nr.9, parashikon ngarkesën mësimore sipas kategorive të stafit, titujve e gradave shkencore. Rregullorja “Mbi punësimin,promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik”, neni 13 përcakton kriteret e rekrutimit të personelit akademik(.evid.nr.7) dhe njëkohësisht kjo praktikë bëhet transparente (Praktika e ndjekur për rekrutimin e personelit akademik.evid.nr.35). Nga kjo praktikë rezulton se është departamenti që paraqet nevojën për personel të ri akademik, me fushën përkatëse të specializimit, me gradën e kërkuae kriteret e tjera të nevojshme për pozicionin. Kriteret bëhen publike në njoftimin e punësimit nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, mbështetur në të dhënat nga takimet në Departament, shqyrtimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, arriti në përfundimet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Personeli akademik, ndihmës mësimor/administrativ i Departamentit të Shkencave Islame i plotëson kriteret e duhura të angazhimit në programin e studimit MSc “Shkenca Themelore Islame”, në përputhje me kualifikimet përkatëse. Nga ana tjetër, konstatohet se realizohet një bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ në përmbushjen e objektivave të programit. Departamenti ka konsoliduar një praktikë pozitive në përfshirjen e stafit akademik për hartimin dhe ndryshimet në kurrikulat, bazuar edhe në trajnime përkatëse, diskutime dhe shkëmbimin e 	

përvojës brenda stafit si dhe sugjerimeve të studentëve.

- c. Rekrutimi i personelit të ri si dhe vlerësimi i tij bëhet në bazë procedurash ligjore dhe transparente, në përputhje me statutin dhe rregulloren. Institucioni disponon një bazë të rregullt të dhënash për personelin.
- d. Stafi akademik, me gradat dhe titujt shkencorë që disponon, i mbulon nevojat e programit, duke vazhduar procesin e kualifikimeve të mëtejshme, në përputhje me objektivat e departamentit e në vecanti të programit të ciklit të dytë.
- e. Udhëheqja e tezave për studentët e programit MSc bëhet duke ndjekur një procedurë të institucionalizuar; udhëheqësit plotësojnë kriteret, si në numrin e studentëve që udhëheqin , ashtu edhe të zotërimit të njohurive të thelluara e përvojës kërkimore në fushën përkatëse të temës që udhëheqin.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, si dhe njohja me dokumentacionin që i referohet infrastrukturës së insitucionit (Ambientet në KUB, evid.nr.21, Planimetria e godinës, evid.23, Model i raportit vjetor institucional 2017-2018, evid.nr .34), të dhënave nga RVB, rezulton se institucioni ka mjedise të përshtatëshme dhe të mirëpajisura në funksion të veprimtarisë së tij si IAL. Departamenti i Shkencave Islame e ushtron aktivitetin e tij në mjedise me kushte të duhura për një proces mësimor, kërkimor e social eficient, ku infrastruktura është në funksion të programeve të studimit. Ndërtesa ka një hapësirë totale prej 5628 m² e përbëhet nga dy godina (A dhe B). Mjediset e tyre kanë infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me kondicionerë. Të dyja godinat kanë mjedise të mësimdhënies si dhe mjedise të tjera, si zyra apo mjedise për aktivitete jashtëkurrikulare (godina B), apo salla e hapësira me destinacione të përcaktuara në funksion të mësimdhënies e kërkimit shkencor, si muzeu i medias, salla e gjyqit, laboratorit i informatikës, etj (godina A). Vec tyre, institucioni ka bibliotekë, mensë, mjedise për veprimtarinë e pavarur studentore, mjedis të shërbimit shëndetësor, bokse hidro-sanitare, palestër etj. Institucioni disponon depozita ujore të mjaftueshme, dalje dhe shkallë emergjence, sistem mbrojtës kundra zjarrit dhe kundër shkarkesave atmosferike. Sistemi i ngrohjes është modern dhe, në rast nevoja, institucioni është i pajisur edhe me burime alternative të energjisë elektrike (motogjenerator).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

(Tabela. 8 ne aneks)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë

- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

(Tabela. 8 në aneks)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Sipas konstatimeve nga vizita në KUB, dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë e godinës (evid.23) rezulton se Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, me mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore Sipas dokumentit të Kontratës së qerasë për godinën (evid.nr.22), dhe nga takimi me dekanin rezulton se mjediset janë në dispozicion, sipas një kontrate afatgjatë, por parashikohet, brenda një afati të shkurtër, ndërtimi i kampusit universitar. Kjo e fundit specifikohet edhe tek Modeli i raportit vjetor 2017-18 (evid.nr.34), ku parashikohet edhe efekti financiar përfitues i mospagesës së qirasë në kushtet e ndërtimit të kampusit. Meqënëse, nga të dhënat e referuara në Departamentin e Shkencave Islame, por edhe sipas RVB, programi i studimit MSc në “Shkencat Themelore Islame” ofrohet në një godinë të vetme, kjo jep mundësi për një menaxhim dhe kontroll efikas të procesit mësimdhënës, në kushtet e një infrastrukture të përshtatshme e të mirëpajisur.</p> <p>Institucioni nuk ofron programe studimi të përmendura në këtë kriter.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekën e Institucionit e bisedat me përgjegjësën e departamentit të Shkencave Islame, përgjegjësen e bibliotekës dhe nga dokumentacioni përkatës (Material i detajuar mbi bibliotekën, evid.nr.36 dhe Ambiente në KUB, evid.nr.21) rezulton se, në dispozicion të studentëve, janë vënë një numër i konsiderueshëm tekstesh mësimore, shoqëruar edhe me literaturë ndihmëse. Fondi i bibliotekës përfshin 36,000 botime, ku 30.000 tituj janë në gjuhët angleze, turke dhe arabe, ndërsa 6.000 tituj janë në shqip. Në bibliotekë ka edhe 100 dokumenta arkivore. Përgjithësisht, literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse është bashkëkohore.</p>

<p>programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka ze një hapësirë prej 230 m2 dhe salla e saj e leximit ka një kapacitet prej 60 vendesh.</p> <p>Nga takimet me stafin akademik e studentët e programit MSc, rezulton se literatura në gjuhët turqisht, anglisht, arabisht, që jepet si e detyruar apo e këshillueshme për lëndët përkatëse të programit apo për përgatitjen e tezës së diplomimit është në përputhje me programet; <i>sidoqoftë nga ana e GVJ, nga vlerësimi i syllabuseve, u sugjerua që të shtohet numri i titujve të literaturës së rekomanduar, brenda mundësisë që ofron edhe online Biblioteka.</i></p> <p>Biblioteka mundëson akses në bibliotekën online EbscoHost, ku studentët kanë akses në mbi 45.000 libra dhe mbi 5.000 revista shkencore. Gjithashtu Biblioteka mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p>
	<p>Nisur nga rekomandimet e akreditimit të parë, departamenti, sic rezulton edhe nga informacioni rreth pasurimit të bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe, evid.nr.14, ka marrë masa duke pasuruar Bibliotekën e IAL me literature në gjuhën shqipe, që vjen kryesisht nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë dhe Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, si dhe shtëpi të tjera botuese. Aktualisht në bibliotekën e universitetit gjenden rreth 7200 tituj lidhur me fushën e shkencave islame ku rreth 30% e tyre janë në gjuhën shqipe, 10% në anglisht, 20% në arabisht dhe 40% në gjuhën turke. Nga vizita e GVJ në Bibliotekë, u konstatua se orari i shërbimit të Bibliotekës është nga ora 08:30 deri në orën 19:00, një orar i duhur, në përputhje me nevojat e studentëve të dy cikleve të studimit. Biblioteka është në dispozicion të studentëve edhe në fundjavë, gjatë sezonit të provimeve.</p> <p>Për të lehtësuar procesin e aksesimit e nevojave për literaturë, në bibliotekë funksionon një sistem automatizimi, që e mundëson online të gjithë procedurën përkatëse të regjistrimit dhe kerkesave të studentëve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1. Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3. Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me stafin e studentët e programit MSc ne “Shkenca Themelore Islame”, rezulton se hapësirat e mjediseve (klasave, zyrave, sallës së kompjuterave, bibliotekës) dhe pajisja e tyre me elementët e nevojshëm (kompjuter, projektor, dërrasë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike etj), nisur edhe nga numri i vogël i studentëve si dhe specifika e departamentit, përgjithësisht janë të mjaftueshme dhe efikase për realizimin e programeve të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion, biseda me stafin e studentët e programit MSc ne “Shkenca Themelore Islame” mbi përshtatshmërinë e bazës materiale me qëllimet e programit, rezulton se mjediset mësimore janë të një standarti të lartë, të mirëpajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si dërrasë</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>interaktive, projektorë, kompjuter, internet etj. Mjediset janë të reja, të mirëmbajtura, ndërsa kondicionimi e ndricimi i duhur japin komoditet dhe i shërbejnë efikasitetit të procesit mësimdhënës. Sipas RVB dhe nga takimi me përgjegjës të stafin e departamentit pohohet se, nisur nga natyra e Fakultetit të Shkencave Humane që nuk operon me laboratorë eksperimentimi, janë vënë në përdorim për studentët dhe stafin e institucionit programe kompjuterike të licensuara, si Windows, MS Office, Adobe etj. Programet e ofruara në Fakultetin e Shkencave Humane, për vetë natyrën e tij, nuk kanë nevojë për laboratorë eksperimentimi.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera që i referohen kushteve infrastrukturore të institucionit, si dhe nga vizitat e takimet në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Kolegji Universitar “Bedër” ka një vendndodhje të përshtatshme, me mjedis qendror administrativ si dhe mjedis të mjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, që sigurojnë kushtet e favorëshme për funksionimin e tij si institucion i arsimit të lartë.
- b. Institucioni ka një bibliotekë me një fond të konsiderueshëm botimesh, që, përgjithësisht, u përgjigjet kërkesave të procesit mësimor me tekste dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore. Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike. Biblioteka ka shtuar fondin e librave në gjuhën shqipe, duke e pasuruar atë me mbi 6,000 tituj të tjerë në shqip (bazuar në RVB dhe vizitën e institucionit). Megjithatë nxitim institucionin që të vijojë me pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës, për t’iu përgjigjur edhe nevojave që lidhen me riorganizimin e ardhshëm, në pritje të miratimit nga MASR, e programeve të departamentit të Shkencave Islame në gjuhën shqipe.
- c. Institucioni vë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore; laboratorët, klasat, zyrat, studiot e sallat respektive janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për këtë qëllim.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas statutit të KUB (Evid. Nr.1), Kolegji Universitar Jopublik “Bedër” është person juridik jofitimprurës, që gëzon autonomi financiare. Kjo autonomi financiare bazohet tek e drejta për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaria e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga shërbimet etj, si dhe për të përfituar fonde apo donacione nga shteti, por edhe organizma të tjerë, si dhe individë. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga pagesat e studentëve dhe donacionet. Autonomia financiare bazohet edhe tek e drejta për të caktuar rregulla të brendshme të financimit e të përdorimit të të ardhurave, për të përcaktuar tarifatat e studimit, por edhe për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që disponon institucioni, në funksion të realizimit të misionit të tij. Bordi i

Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar I institucionit që varet nga Bordi I Administrimit. Ai është njekohësisht përfaqësuesi ligjor i Kolegjit për çështjet financiare dhe administrative. Sipas nenit 54 të Statutit, administrator harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore e bazë, mbështetur në Planin Strategjik të Zhvillimit të KUB dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij, propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit në strukturat e varësisë së tij, zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik, me karakter financiar dhe administrative dhe I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit, në përfundim të çdo viti akademik. Sipas nenit 56 të Statutit, fakultetet kanë edhe administratorin e tyre përkatës, I cili është përgjegjës për mirefunksionimin financiar e administrativ të njësisë kryesore, duke realizuar administrimin e përditshëm financiar të fakultetit dhe duke mbikëqyrur e kontrolluar veprimtarinë financiare të fakultetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

(Tabela 9 në aneks)

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Bazuar në RVB si dhe në modelin e raportit vjetor institucional 2017-18 (evid.nr 35), shpenzimet për student për vitin akademik 2013-2014 ishin 177,066 Lekë; për vitin 2014-2015 ishin 210,543 Lekë, për vitin 2015-2016 ishin 215,637 Lekë; për vitin 2016-2017 ishin 165,449 Lekë, ndërsa për vitin 2017-2018 ishin 153,619 Lekë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Nga shqyrtimi i raportit vjetor institucional 2017-2018 (evid.nr.34), rezulton një pasqyrim i hollësishëm i situatës financiare lidhur me të ardhurat e shpenzimet e institucionit. Në raport është përfshirë edhe pasqyra e planit buxhetor afatmesëm dhe plani strategjik i zhvillimit të institucionit 2018-2022, me shifrat e parashikuara të të ardhurave e shpenzimeve përkatëse. Nga shqyrtimi i raportit të auditit ka tregues që pasqyrojnë donacionet e grantet në favor të programeve të studimit, por pa i specifikuar. Raporti bën bilancin e të ardhurave nga tarifatat e studentëve, duke evidentuar diferencën midis parashikimit dhe realizimit të të ardhurave si dhe faktorët
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfuturave dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	

<p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifrat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>që kanë ndikuar në bilancin financiar, si ulja e tarifave, apo heqje e tyre, lëvizja e numrit të studentëve, etj.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Sic evidentohet nga raporti i sipërcituar (evid. Nr 34), në të paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative etj. Raporti jep një pasqyrë financiare edhe të donacioneve të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Në raportin vjetor kostot operacionale, jepen në termat e parashikimit dhe realizimit, duke evidentuar edhe diferencat ne mosrealizimet e arsytet përkatëse. Kështu , sic evidentohet nga raporti i sipërcituar (evid. Nr 34) institucioni, për vitin 2017-2018, për arsye të uljeve që u ofroi studentëve nuk arriti të mbledhte shumën e parashikuar të të ardhurave, por arriti ta kompensojë këtë diferencë me anë të uljes së shpenzimeve operative prej 6% më pak se parashikimi, duke mos ndikuar në këtë mënyrë te pagat e personelit.</p> <p>Nga analiza e situatës financiare që jepet në raport si dhe nga plani buxhetor afatmesëm i pasqyruar në të, rezulton përpjekja e institucionit për të patur e parashikuar qëndrueshmëri financiare, në funksion të realizimit të programeve të studimit. Duke iu referuar raportit, evidentohet synimi për hapjen e programeve të reja, cka parashikon rritje në numrin e studentëve, pra edhe rritje të të ardhurave prej 14%-16%. Gjithashtu në raport theksohet synimi për ulje të shpenzimeve operative për vitin akademik 2020-2021, meqë nuk do ketë më shpenzime të qerasë e godina do të jetë e institucionit. Diferenca e përfutur parashikohet te shërbejë për përmirësimin e situatës financiare në institucion</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga njohja me raportin vjetor të institucionit lidhur me burimet financiare e menaxhimin e tyre nga institucioni, si dhe nga informacionet me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Islame, konstaton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Institucioni realizon cdo vit raportin e analizës së situatës financiare, me indikatorët përbërës. Në të jepet një pasqyrë e grandeve e donacioneve të përfuara si dhe analizohet eficientia e përdorimit të ardhurave nga tarifrat e studentëve, në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve edhe në këtë cikël studimesh. b. Institucioni ka dëshmuar një menaxhim të mirë të burimeve financiare dhe se ka kapacitetet e nevojshme për njëqëndrueshmëri financiare. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ mori informacion lidhur me sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë nga takimet në institucion me dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjës in dhe departamentit dhe stafin akademik, studentët e përfaqësues të strukturave përkatëse institucionale të ngritura për këtë qëllim si dhe u njoh me raportin e GVB e dokumentacionin përkatës. Konstatohet se në institucion, mbështetur në ligjin e arsimit të lartë, në dispozitat e Statutit të KUB (evid. nr 1, kreu VIII, neni 28, 29) dhe në Rregulloren Themelore të KUB (evid. nr 2, neni, 14) funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, me dy struktura të posaçme për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj: a) Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit dhe b) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Të dy strukturat kanë autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat që lidhen me veprimtaritë mësimore dhe shkencore të institucionit. Veprimtaria e tyre bazohet në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në Statutin e Rregulloren Themelore të institucionit si dhe rregulloren specifike ("Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë - NJSBC"), evid. nr. 37. Sipas Rregullores Themelore të KUB, Komisioni është organi përgjegjës që vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore. Komisioni kryen kontrollin periodik dhe ndjekjen e përmirësimin të cilësisë. Ngrihet me vendim të Senatit Akademik dhe ka në përbërjetre anëtarë të Senatit Akademik; një përfaqësues nga Këshilli studentor, një ekspert të jashtëm. Komisioni miraton standartet, politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve, në bashkëpunim me njësitet e tjera të institucionit, monitoron sigurimin e cilësisë së stafit akademik, i jep urdhra dhe direktiva për zbatim Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Struktura tjetër, NJSBC, sipas Statutit, përbëhet nga pesë anëtarë: tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm. (tabela 10 ne aneks). Kjo njësi ka në kompetencat e saj mbështetjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale. Ajo është përgjegjëse si për hartimin e standarteve, të politikave e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ashtu edhe për realizimin, në mënyrë periodike, të vëzhgimeve dhe analizave mbi ecurinë e rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në departamente, në përputhje me standardet.

NJSBC ndjek e monitoron procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit e përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit. Njësia kryen vëzhgime edhe mbi efikasitetin e programeve të ofruara dhe ecurinë e punësimit të studentëve. Para sezonit të provimeve, në fund të çdo semestri, NJSBC, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, organizon pyetësorin studentor, të përgatitur me indikatorët përkatës, sipas të cilëve studentët vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies për lëndët, specifikiisht në çdo program studimi. Në janar 2010, KUB është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, (evid.nr.11). Programet e ciklit të parë dhe të dytë të Departamentit të Shkencave Islame, në kuadër të KUB, kanë kaluar me sukses akreditimin në vitin 2013, ndërsa në periudhën tetor-dhjetor 2014 është realizuar edhe një vlerësim i jashtëm i cilësisë (evid.nr 25). Sipas RVB, për mbikqyrjen e zbatimit të proceseve dhe procedurave sipas standardit ISO, në institucion funksionin, çdo vit, Grupi i Auditit të Brendshëm Ad-hoc, që me anë të auditimit periodik kontrollon zbatimin e proceseve dhe procedurave të sigurimit të cilësisë në institucion.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Nga të dhënat e përfaqësuesve të NJSBC dhe shqyrtimi i RVB (rubrika 7), KUB bën vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik, mbështetur në Rregulloren e anketave dhe vlerësimeve (evid.nr.6). Sipas kësaj rregulloreje, merret informacioni i duhur për vlerësimin e procesit mësimdhënës, kërkimor-shkencor dhe administrativ nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, administrativ dhe studentët. Format e anketimit përfshijnë anketën vetëvlerësuese të stafit akademik, anketën vlerësuese

të stafit akademik ndaj institucionit, anketën vlerësuese të stafit administrativ ndaj institucionit, anketat vlerësuese të studentit ndaj stafit akademik dhe institucionit. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohen sipas rregullores përkatëse (evid.6.). Anketimet me studentë zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri. Sipas përfaqësuesve të NJSBC, deri tani janë zhvilluar 12 anketime me studentë. Në to, studenti informon mbi indikatorë të cilësisë, që lidhen me përgatitjen profesionale të pedagogut, performancën, qartësinë, korrektësinë, vlerësimin objektiv, efikasitetin e lëndës në raport me pritshmëritë, metodat e mësimdhënies, përdorimin e teknologjisë, literaturën e rekomanduar, figurën e marrëdhënien etike me studentin (Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.evid.nr.26). Të dhënat përpunohen nga njësia përkatëse e i bëhen të njohura përgjegjësit të departamentit e me tej, stafit respektiv. Nga takimi me përfaqësuesit e NJSBC, përgjegjësi i departamentit, si dhe studentët, u konstatua se, përgjithësisht, nuk ka patur probleme serioze nga rezultatet e anketimeve, ndërsa ato u janë bërë të njohura, nëpërmjet titullarit të departamentit, antarëve të stafit, për një përmirësim të mëtejshëm të punës së tyre mësimore e kërkimore.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Sipas të dhënave nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Islame dhe përfaqësuesit e NJSBC, mbështetur edhe në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës (RVB, Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve, evid.nr.6; Rregullorja për funksionimi n dhe organizimin e NJSBC, evid.nr.37; Praktikë e auditimit të brendshëm, evid.nr.19; Anketë vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët, evid.nr.26; Shëmbull i masave të marra nëkuadër të akreditimit të parë, evid.nr.24), rezultoi se KUB aplikoi një sistem procedurash për kontrollin e brendshëm të cilësisë. Sipas këtyre procedurave, çdo fund semestri dhe viti akademik, bëhet vlerësimi i stafit akademik me anketimet dhe vlerësimet e studentëve, por edhe vetëvlerësimet nga stafi si dhe vlerësimi i eprorëve për vartësit. Me urdhër të Rektorit është ngritur e ka funksionuar, në kuadër të një procesi vetëvlerësimi, edhe një komision auditimi i posaçëm, për të gjykuar e kontrolluar mbi administrimin, në përputhje me rregulloren, të dokumentacionit të brendshëm në Departamentin e Shkencave Islame. Është verifikuar dokumentacioni mbi vendimarrjen e njësive akademike, procesverbalet e vendimet e Këshillit Shkencor, listprezencat e mbledhjeve, baza e të dhënave për stafin me analizën kualitative e kuantitative, dosjet e ngarkesës së personelit, programet mësimore me indikatorët përkatës, procedura e vlerësimit të stafit, dokumentacioni mbi aktivitetet shkencore e ato akademike, publikimet, projektet, programi i trainimeve të stafit, programi i konsultimeve të studentëve për temat e diplomave, baza e të dhënave për studentët, shkalla e përditësimit të web-it, etj. Mbi bazën e konstatimeve, komisioni ka lënë me shkrim pranë Departamentit vërejtjet e detyrat përkatëse për zbatim (Praktikë e auditimit të brendshëm, evid.nr.19). Anketimet realizohen edhe në lidhje me cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni, me veprimtarinë administrative, duke iu drejtuar, për plotësimin e tyre, personelit akademik, administrativ dhe studentëve.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Sipas përgjegjësit të Departamentit dhe përfaqësuesve të NJSBC, njësia bazë bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me këtë njësi të specializuar administrative, që organizon, monitoron e përpunon rezultatet e procesit të kontrollit të cilësisë. Të gjitha të dhënat, që dalin nga format e kontrollit të cilësisë në institucion, janë të matshme dhe transparente, si nëpërmjet rrugëve të komunikimit të tyre të drejtpërdrejtë, ashtu edhe nëpërmjet sistemit online, në faqen e web të institucionit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Një tjetër tregues i procesit të vlerësimit e institucionalizimit të kontrollit të cilësisë është edhe hartimi i raportit vjetor në çdo fund viti, nga njësiti bazë dhe kryesore (departamenti e fakulteti) që dërgohet në rektorat. (Model i raportit vjetor institucional, evid.nr.34; Model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr.20) Në këto raporte, analizohet hollësisht veprimtaria e institucioni, ku rëndësi merr edhe analiza SWOT, si tregues i nivelit të ndërgjegjshmërisë, përgjegjësisë dhe kompetencës lidhur konstatimet dhe rrugët e përmirësimit të cilësisë në institucion. Nga ana tjetër, këto raporte bëhen transparente për personelin e njësive kryesore, bazë dhe administrative, për shkëmbim përvojash e idesh për përmirësimet përkatëse dhe për t'i shërbyer hartimit të detyrave e planit të aktiviteteve për të ardhmen. Në fokus të

vlerësimit të cilësisë në institucion është edhe fusha e infrastrukturës dhe e shërbimeve logjistike, qoftë me procedurën e anketimeve, ashtu edhe të analizave institucionale.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në institucion, sipas të dhënave nga përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Islame dhe përfaqësues të NJSBC, mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike, aplikohen edhe politikat për përmirësimin e cilësisë, me bërjen transparente të rezultateve e komunikimit të tyre, në rrugë institucionale, personelit përkatës, me daljen e tyre në sistemin online, me analizat e raporteve vjetore e mbledhjet e prezantimit të tyre, etj. Një tjetër procedurë është ajo që lidhet me ankimin e studentëve (nëse ka), që i drejtohet sekretarisë mësimore dhe, më pas, kalon në departament; përgjegjësi i departamentit ngre, për këtë qëllim, një komision për shqyrtimin e ankesave dhe marrjen e masave përkatëse.

Nga ana tjetër, vihet re se, në planin e trainimeve që organizohen në institucion periodikisht, me personelin akademik e administrativ, tematikat e trajtuara i shërbejnë drejtpërdrejtë e në tërësi çështjes së forcimit të cilësisë e performancës në të gjitha aspektet e veprimtarisë mësimdhënëse, kërkimore-shkencore e administrative të institucionit. (Lista e trainimeve të personelit akademik dhe administrativ, evid.nr.30)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme</p>	<p>Nga të dhënat nga takimi me përfaqësuesit e NJSBC, të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit në Fakultetin e Shkencave Humane, por edhe nga takimet me titullarët e institucionit (njësisë kryesore e bazë) rezulton se në institucion aplikohen metodologji vlerësimi e instrumenta matës e vlerësues për ecurinë e programeve të studimit. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura nga njësia e specializuar, studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe brendinë e lëndës. Kjo anketë realizohet para provimit përfundimtar të çdo semestri. Realizimi i anketimit mbi performancën e personelin akademik nga ana e studentëve, përfshin komponentë të mësimdhënies, metodologjisë, literaturës e teknologjisë në auditor, që lidhen drejtpërdrejtë me vlerësimin e ecurisë së programit të studimit (Anketë vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët, evid.nr.26).</p> <p>Një tjetër instrument vlerësimi për ecurinë e programit të studimit është plotësimi i Formularit të vlerësimit të performancës së stafit akademik (evid. nr.18), nga cdo anëtar i stafit akademik, lidhur me ecurinë e aktivitetit mësimdhënës e shkencor në fushën që ai mbulon, si një vetëvlerësim, duke përcaktuar edhe objektiva, në përputhje me strategjinë e departamentit për përmirësimin e aktivitetit në të ardhmen. Në këtë formular, një seksion i takon vlerësimit të eprorit (përgjegjësit të departamentit) mbi punën e vartësit, sipas kriteresh të përcaktuara e që i bëhet e njohur atij, me hapësirë edhe për komente.</p> <p>Gjithashtu edhe auditimi i brendshëm që zhvillohet nga</p>

<p>të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p>	<p>komision Ad-Hoc i ngritur nga rektori, evidenton problematikat e dokumentacionit, si një tjetër tregues që lidhet me vlerësimin e nivelit e të ecurisë së programit, duke lënë edhe detyra për përmirësime përkatëse (Praktikë e auditimit të brendshëm, evid.nr.19). Vlerësime për programet bëhen edhe nga ekspertë të jashtëm. (Raport i vlerësimit të jashtëm i kërkuar nga IAL, evid.nr.25)</p>
<p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Nga të dhënat e marra nga përgjegjësi i Departamentit e përfaqësues të NJSBC si dhe nga dokumentacioni përkatës, konstatohet se Institucioni (Njësia kryesore edhe bazë) e përfshin informacionin e vlerësimit të programeve të studimit në procesin e vetëvlerësimit, për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kështu, rezultatet e anketimeve, ankimitet e studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore, përcillen nga përgjegjësi i departamentit tek stafi i njësisë. Nga ana tjetër, bazuar edhe në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC (evid.nr.37), njësia bazë, në raportin e vlerësimit të brendshëm, apo njësia kryesore në raportin vjetor institucional (që i dërgohet edhe MASR), raportojnë në bazë të parametrave dhe rregullave të vlerësimit të brendshëm, të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë. (Kodi i cilësisë). Në këto raporte vlerësimi të brendshëm, rol të rëndësishëm luan analiza SWOT dhe plani i masave përmirësuese, në bazë të rekomandimeve të Komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë së njësive. (Model i raportit vjetor institucional, evid.nr.34; model i raportit vjetor të departamentit, evid. Nr.20)</p> <p>Nga të dhënat e marra në institucion, nga RVB e dokumenta të sipërcituara, del në pah se institucioni (departamenti), në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe në planin strategjik institucional (evid.nr. 13), evidenton rezultatet e vlerësimit dhe objektivat që kërkon të arrijë në drejtim të përmirësimit të cilësisë e treguesve të saj. Sipas përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Islame dhe stafit akademik, në mbledhjet e departamentit analizohen problematikat lidhur me kurrikulat e brendinë e lëndëve, nisur edhe nga rezultatet e anketimeve që vinë nga NJSBC dhe procesi i vetëvlerësimit të stafit akademik. Konkluzionet dhe vendimarrjet në departament dërgohen për miratim në Dekanatin e fakultetit, për t'u miratuar më pas nga Senati. Plani strategjik institucional i KUB për periudhën 2018-2023 (evid.nr.13) parashtron objektivat dhe planin e veprimeve institucionale edhe në drejtim të sigurimit e përmirësimit të cilësisë në veprimtarinë e institucionit.</p> <p>Duke gjykuar mbi Anketën vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët, (evid.nr.26), që aplikohet periodikisht si formë vlerësimi , konstatohet se ky model anketimi përfshin metoda të tërthorta vlerësimi, në seksionet që</p>

	<p>kanë pyetje mbi përmbajtjen e lëndës, mbi performancën e pedagogut të lëndës, mbi shërbimin e ofruar nga institucioni, pyetje konceptuale e rekomandime nga studentët. Nga ana tjetër, metoda të drejtpërdrejta janë ato të aplikuara, p.sh. në syllabuset e lëndëve e që përfshijnë vlerësimin me pikë për aktivizimin në auditor, vlerësime me notë dhe me pikë, vlerësim të detyrave, vëzhgime të kryerjes kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, vlerësim në projektet e realizuara në grup, për testimet ndërmjetëse semestrale, për teste finale në përfundim të semestrit, etj. (Model i raportit vjetor të departamentit, evid.nr 20; RVB)</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Konstatohet se në faqen e internetit të KUB gjenden të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimit dhe ato institucionale, të cilat janë përgatitur në kuadër të procesve të akreditimit të zhvilluara në vitin 2013 dhe 2017. Sipas GVB e përgjegjësit të departamentit të Shkencave Islame, edhe RVB aktual parashikohet të publikohet në faqen e web të NJSBC.</p> <p>Konstatohet se në faqen e internetit të institucionit dhe në faqen e posaçme të NJSBC dhe Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit (www.qac.beder.edu.al) publikohen rregullisht raportet, informacionet e prezantimet për vlerësimin e brendshëm, duke i bërë transparente e të matshme.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga takimi në institucion me përgjegjësin e Departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se Departamenti harton çdo vit një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve, përfshirë edhe ato të ciklit të dytë. (Model i analizës vjetore të departamentit, evid.nr.20). Në të analizohet plani mësimor, me treguesit përkatës, jepen të dhëna mbi plotësimin e kushteve për pranimin në këto programe e të dhëna statistikore për mesataren e studentëve, por edhe një pasqyrë të veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit të programit, si tregues që reflekton në cilësinë e realizimit të programeve të ciklit të dytë. Raporti përmban edhe analizën SWOT e cila, duke evidentuar veç përparësive edhe pikat e dobta e mundësitë që departamenti ka në përmirësimin e realizimit të programeve, njëkohësisht shërben edhe si referencë për ndjekjen e realizimin e objektivave të vitit pasardhës akademik. <i>Sidoqoftë, nga shqyrtimi i këtij raporti (përfshirë edhe analizën SWOT me rubrikën që evidenton "pikat e dobta"), jemi të mendimit se ai ka më tepër karakter përshkrues. Duke qënë analiza më e rëndësishme vjetore e departamentit, mendojmë se raporti ka nevojë për një qasje më të thelluar e problemore në vlerësimin e cilësisë e permbushjes së kriterëve të saj, që ndikojnë në</i></p>

	<p><i>ecurinë e programeve të studimit. Në varësi të kësaj analize, në raport mund të vihen në dukje, nga një qasje e qartë dhe e mbështetur në kritere, edhe objektiva e masa përkatëse nga ana e departamentit, që përmirësojnë punën në drejtim të cilësisë, si të mësimdhënies, ashtu edhe të kërkimit shkencor.</i></p>
	<p>Duke shqyrtuar Planin Strategjik të KUB, (evid. nr.13), konstatohen objektivat e synimet e institucionit, si edhe plani i veprimeve për përmirësimin e programeve të studimeve, duke përfshirë domosdoshmërisht edhe të ciklit të dytë. Lidhur me politikat e përmirësimit të programeve të ciklit të dytë, ndër të tjera, synohet drejt një qasjeje e cila, si në procesin e mësimdhënies, ashtu edhe atë të vlerësimit, i aftëson studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, për t'i përgatitur në mënyrë më efektive për sfidat e ardhshme. Synohet zbatimi i një metodologjie vlerësimi, që bazohet plotësisht në ndërtimin e aftësive të të menduarit kritik. Në favor të përmirësimit të cilësisë së realizimit të programeve, synohet nxitja dhe mbështetja edhe më e madhe e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve të “Master” në projekte dhe veprimtari kërkimore-shkencore. Institucioni synon forcimin e mëtejshëm të kritereve të pranimit të studentëve në programet “Master”, duke patur për qëllim tërheqjen e studentëve më të mire, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në Planin Strategjik, vlerësohet si faktor i rëndësishëm promovimi më efikas i institucionit dhe i programeve të studimit, me qëllim tërheqjen e studentëve më të mire, mundësia për zgjerimin e hapësirave të punësimit, forcimi i marrëdhënieve me të diplomuarit në programet “Master”, etj. I takon departamentit t’i zbërthejë e realizojë këto politika, në përputhje me mundësitë, fizionominë e perspektivat e fushës që mbulon, duke patur si objektiv parësor forcimin e cilësisë sipas standarteve në veprimtarinë mësimdhënëse e kërkimore-shkencore.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit</p>	<p>Sipas RVB e dokumentacionit përkatës, (Urdhër nr: 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”, evid.nr.15; ISO Certifikatë 9001:2008, evid.nr.17), institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional, përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve. Ai ka kaluar me sukses 2 akreditime institucionale, të parin në vitin 2013 nga APAAL dhe të dytin në vitin 2017 nga agjensia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (të sipërcituar), që ka lidhje me sigurimin e cilësisë në institucion e ne programet që ofron departamenti i Shkencave Islame si dhe nga takimet në Institucion, konstatohet se Institucioni përdor instrumentet e</p>

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

duhura për sigurimin e cilësisë;, duke ngritur dhe bërë efektivë dy strukturat përkatëse: Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit dhe NJSBC, me autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtaritë mësimore dhe shkencore. Funksionimi dhe kompetencat e këtyre njësisve janë të specifikuara në rregulloret përkatëse të referuara në këtë raport.

Nga i gjithë dokumentacioni i shqyrtuar dhe i sipërcituar në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe standarteve të programeve, si dhe takimet në institucion, konstatohet se, si njësia kryesore, ashtu edhe departamenti, hartojnë politika e ndjekin procedura institucionale për këtë qëllim. Sidoqoftë, kjo mbetet për të ardhmen një prioritet i domosdoshëm; në Planin Strategjik ka objektiva që lidhen drejtpërsëdrejti me arritjen e synimeve edhe përsa i përket forcimit të cilësisë e standarteve të saj. Propozimi për ndryshimin e programeve mësimore bëhet në njësinë bazë, për të kaluar e ndjekur procedurën, sipas Statutit dhe Rregullores së institucionit, në njësinë kryesore e rektorat; është Senati i cili vlerëson e miraton ndryshimet përkatëse. (evid.nr.1 dhe evid.nr.2)

Nga vizita në institucion e takimet me stafin akademik, studentët, dekanin e fakultetit dhe përgjegjës të departamentit, bazuar edhe në dokumentacionin e sipërcituar, konstatohet se institucioni në përgjithësi e departamenti në vecanti, me procedura institucionale, format e ndërgjegjësimit nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të materialeve që analizojnë cilësinë e programeve sipas standarteve, trainimeve të stafit akademik, guidave të studentëve e stafit, formave të vlerësimit e vetëvlerësimit të cilësisë, janë përpjekur të ndërgjegjësojë personelin dhe studentët e programeve MSc mbi rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë së programeve. Një konferencë e posacme ndërkombëtare është organizuar nga institucioni, pikërisht me tematikë: “Sfidat dhe zhvillimi i cilësisë në arsimin e lartë”, me trajtesa bashkëkohore e të bazuara në qasje e përvoja pozitive të IAL-ve, brenda e jashtë vendit. GVJ konstaton se institucioni e ka mbështetur punën e deritanishme në drejtim të cilësisë në procedura të bëra publike dhe në përputhje me standartet; në Planin Strategjik të Institucionit 2018-2023 është hartuar strategjia e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë, me politikat dhe planin e detajuar të masave për zbatimin e tyre. (evid.nr.17).

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ, nga takimet në institucion me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjës dhe stafin akademik të departamentit të Shkencave Islame, përfaqësues të studentëve të programit MSc në “Shkenca Themelore Islame”, përfaqësues të strukturave të sigurimit të cilësisë, si dhe nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit që i referohet problematikave të cilësisë e zbatimit të

standarteve të saj në institucion, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Departamenti i Shkencave Islame, në kuadër të veprimtarisë së institucionit ku bën pjesë, Fakultetit të Shkencave Humane, aplikon, në rrugë institucionale, një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve, përfshirë edhe programin MSc në “Shkenca Themelore Islame”. Pjesë e procesit të vlerësimit dhe vetëvlerësimit është stafi pedagogjik, studentët, që vlerësojnë programin e studimit dhe performacën e pedagogëve, si dhe shërbimi administrativ i institucionit.
- b. Institucioni ka një praktikë transparente të publikimit të rezultateve të vlerësimit të brendshëm; raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, broshura, prezantime e buletine për këtë qëllim, publikohen në faqen web të tij.
- c. *Departamenti bën analizën vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit, përfshirë edhe ato të ciklit të dytë; analiza SWOT ndihmon në evidentimin e problematikave që lidhen me cilësinë, por sugjerohet që kjo analizë, në tërësi, të jetë më pak përshkruese. Raporti ka nevojë për një thellim më problemor dhe efektiv në vlerësimin e cilësisë e problematikave të saj, që lidhen me ecurinë edhe të programeve të studimit të ciklit të dytë. Në varësi të kësaj analize, në raport mund të vihen në dukje, nga një qasje e qartë dhe e mbështetur në kriteret, edhe objektiva e masa përkatëse që përmirësojnë punën në drejtim të cilësisë, qoftë të mësimdhënies, ashtu edhe të kërkimit shkencor.*
- d. KUB ka bërë publike Planin Strategjik 2018-2023, me objektiva strategjike, politika dhe masa zbatimi për ecurinë e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, ku merr përparësi edhe përmirësimi i cilësisë, sipas standarteve. Kjo strategji orienton edhe Departamentin e Shkencave Islame, në realizimin e programeve të studimit, për politikat e masat për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të programeve të ciklit të dytë, përfshirë edhe atë MSc në “Shkenca Themelore Islame”.
- e. *Departamenti është në pritje të miratimit nga MASR të kërkesës për riorganizimin e programit MSc në “Shkenca Themelore Islame” e ndryshimin e emertimit në “Shkenca Islame”. Sidoqoftë, konstatohet se është i domosdoshëm, për të forcuar e rritur cilësinë dhe efikasitetin e programit, rishikimi i përmbajtjes së tij, për t'i dhënë fizionomi dalluese nga programi tjetër MSc në “Shkenca Moderne Islame”, pasi një sërë lëndësh janë të njëjta.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se Departamenti i Shkencave Islame, në kuadër të institucionit, i përmbush kriteret që realizojnë sigurimin e cilësisë në programin përkatës MSc në “Shkenca Themelore Islame”. Sidoqoftë, mbetet problem ngjashmëria që ka, për shkak të lëndëve të përbashkëta, ky master me masterin tjetër në “Shkenca Moderne Islame”

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Islame në KUB, misioni i programit është të përgatisë studentë me njohuri jo vetëm në shkencat fetare por

edhe ato sociale dhe shkencore. Programi përmban 15 lëndë dhe tezën e diplomës (në fund të studimeve). Nga pikëpamja e komponentëve përbërës, programi shtrihet përgjatë dy viteve akademike, ku çdo vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Lëndët dhe modulet e këtij programi synojnë të përgatisin studentët me dije dhe aftësi mbi kërkimin shkencor dhe angazhimin e tyre në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me fenë Islame në vend.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame” u hap në vitin akademik 2011-2012. Objektivat formues të programit parashikohen në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, neni 3 i saj. Programi “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e shkencave themelore islame.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame” organizohen sipas sistemit me kohë të plotë. Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamenti i Shkencave Islame, vendim i Këshillit të Fakultetit dhe të miratuar me vendim të Senatit Akademik të KUB. Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame” pajisen me diplomë “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”.

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 50 min

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

(Tabela nr.11)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 720 orë në auditor dhe 1830 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 32 orë në auditor dhe 418 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka ndryshime në planin mësimor nga ai i licensuari.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Tabela nr.13 ne anekse) dhe nga takimi me drejtuesit e departamentit dhe të stafit akademik konstatohet se ka ndryshime të pedagogëve përgjegjës të lëndës, ku e njehta lëndë jepet nga pedagogë të ndryshëm nga një vit akademik në tjetrin. Arsyeya lidhet me mobilitetin e pedagogëve të huaj.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Bazuar në punimin e paraqitur nga RVB Syllabuset janë të organizuara në përputhje të plotë me udhëzimet e nxjerra nga ministria përgjigjëse për arsimin në RSH. Ato janë të ndara në disa nëndarje kryesore ku përfshihet emri i lëndës, grupi, ECTS, orët, pedagogu titullar dhe asistenti, përshkrimi i lëndës, objektivat kryesore, programi i Lëndës së bashku me literaturën përkatëse, Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat. Syllabuset ofrohen në fillim të çdo semestri akademik dhe ato përditësohen në mënyrë periodike nga pedagogët, të cilët e kanë këtë detyrim edhe në formë elektronike (pasi sistemi nuk i lejon të aksesojnë elektronikisht lëndën nëse nuk i kanë përditësuar më parë silabuset).

Nga analiza e silabuseve mund të parashtrihen vërejtjet e mëposhtme:

- *Konstatohet se programi i lëndës së metodës së kërkimit shkencor ka më shumë natyrë sociologjike, ndërkohë që duhet të përfshijë edhe lëndë metodike për studimet teologjike, siç është hermeneutika, etj.*
- *Duhet të qartësohen programet në lidhje me filozofinë e fesë. Të dallohet qartë filozofia e fesë nga filozofia fetare, pasi nuk janë identike.*
- *Në silabusin e edukimit fetar duhet të përfshihen edhe dokumentet ndërkombëtare, që kanë si objekt këtë edukim, si dokumente të OKB, KE, OSBE, etj.*
- *Lista e literaturës së rekomanduar mund të jetë më e gjatë dhe jo të kufizohet në dy ose tre tituj.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Master Shkencor në Shkenca Themelore Islame ofrohet në përputhje me kriteret ligjore, me objektiva dhe rol të përcaktuar qartë. Programi është akredituar për herë të parë në vitin 2013 dhe zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga MASR. Referuar rregullores së institucionit për programin e studimit, studimet në këtë program janë të organizuara në module dhe kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.</p> <p>Kreditet janë të shpërndara në 2 vite, ku secili vit ka 60 ECTS. Studentët për tu diplomuar duhet të grumbullojnë 120 ECTS. Llogaritja e krediteve është në përputhje me kriteret ligjore.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi MSc në “Shkenca Themelore Islame”, bazuar në lëndët e syllabuset konstatojmë se i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor”, me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike në fushën në fjalë si dhe me aftësi e kompetenca për kërkim shkencor e kualifikim të mirëfilltë profesional.</p> <p>Programi i studimeve “Master i Shkencave” në Shkenca Themelore Islame, ofruar nga Departamenti i Shkencave Islame, është konceptuar për të zgjeruar njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>KUB, aktualisht, nuk ofron programe studimi të ciklit të dytë të integruara në këto fusha.</p> <p>Bazuar në takimin me përgjegjës të departamentit, studentët, syllabuset dhe praktikën e studentëve, programi i studimit Msc në Shkenca Themelore Islame, mundëson formësimin e studentëve me dije dhe kompetenca profesionale të përgjithshme. Njohuritë e fituara në këtë cikël studimesh i shprehëjnë studentëve për tu zgjeruar më tej në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Përmbajtja e syllabuseve ka qenë në përputhje me objektivat formues të programit të cituar në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, neni 3 i saj.</p> <p>Departamenti i shkencave islame pranë KUB nuk ofron programe studimore “Master profesional”.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodën e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Nisur nga analiza e kurrikulave e syllabuseve të lëndëve përkatëse të programit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame”, vihet re se përmbajtja dhe renditja e objektivave të këtij programi synon arritjen e qëllimeve të tij, në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ato ofrohen.</p> <p>Siç përcaktohet në evidencën nr. 5 metodat e vlerësimit shprehen në syllabus-et e çdo lënde, vlerësimi në varësi edhe të pedagogut ndahet në provime gjysëm finale, provime finale, projekte, kuize, dhe pjesëmarrja në mësim. Këto mënyra vlerësimi i prezantohen studentit nga pedagogu përkatës që në fillim të semestrit me anë të syllabuseve.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të</p>	<p>Gjatë bashkëbisedimit me përfaqësues të stafit akademik, me drejtues të Departamentit dhe fakultetit, por dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi kurrikulën e programit Master i shkencave në Shkenca Themelore Islame, mbështetja ka qenë në përvojat</p>

<p>përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>dhe praktikatat e arsimit universitar dhe atij pasuniversitar të vendeve evropiane, sigurisht në përshtatje me kontekstin e nivelit dhe perspektivës së vendit tonë në këtë fushë. Ka referenca në modele dhe aplikime të universiteteve e programeve universitare të vendeve evropiane.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjisllacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi në fokus të këtij vlerësimi reflekton vlerat më të mira evropiane, duke funksionuar si një model i provuar në garantimin e cilësisë në Shkencat Islame. Treguesit si, planet mësimore dhe ato të realizimit të praktikave profesionale, sistemi i kreditimit për rezultatet e studentëve, metodat e vlerësimit për njohuritë dhe shprehitë që ata kanë fituar në këtë program studimi të nivelit të dytë, fluksi i literaturës së rekomanduar për lëndët, infrastruktura në shërbim të mësimdhënies dhe punëve të pavarura etj., janë garanci për konkureshmërinë e programit ndërkombëtarisht. Programi i studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame, është hartuar në përputhje të plotë me Kartën e Bolonjës dhe kërkesat e saj.</p>

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Për programin e Masterit në Shkenca Themelore Islame kombinohen dy komponentët, kërkimi shkencor dhe aftësimi profesional. Përveç programit që i angazhon ata në procesin e praktikës dhe kontributit në fushën e shkencave Islame, ku një pjesë e studentëve janë të punësuar në këtë fushë. Njëkohësisht atyre u duhet të angazhohen dhe në detyra a projekte, si dhe në ideimin dhe përgatitjen e tezës, si një investim i tyre në kërkimin shkencor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ecurinë e programit të studimit në Master i shkencave në Shkenca Themelore Islame, evidentohet përputhja e tyre me profilin e Kolegjit, por dhe përputhja e natyrës dhe konceptimit të Fakultetit të Shkencave Humane, ku përfshihet dhe Departamenti i Shkencave Islame.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të programit konstatuam se stafi prezanton punën kërkimore dhe shkencore që në fillim të vitit akademik tek Departamenti, përmes një plani të detajuar në kontributet e pritshme dhe afatet kohore për ecurinë dhe finalizimin e tyre. Ky angazhim i personelit akademik të programit Master Shkencor në Shkencat Themelore Islame, është në përputhje me synimet dhe objektivat e tij, pasi dhe personeli i rekrutuar, qoftë me kohë të plotë, qoftë me kohë të pjesshme është në sinkron me interesin dhe kontributin personal kërkimor dhe shkencor. Pra ka përputhje mes synimeve të programit dhe profilit shkencor të personelit akademik që është i angazhuar aty.</p>

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame nuk ofron program studimi “Master profesional”. Sidoqoftë programi i studimit MSC në Shkenca Themelore Islame është bazuar në nevojat e tregut sipas</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të</p>	

plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	studimesh paraprake dhe në funksion të nevojave të KMSH. Departamenti i Shkencave Islame nuk ofron <i>Master Professional</i> .
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Bazuar në takimin me pergjegjësien e departamentit dhe studimin e tregut GVJ konstatoi se Departamenti e ka hartuar programin në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar dhe duke analizuar nevojat e tregut. Departamenti ka përgatitur një studim tregu në vitin 2016 ku ja ka bashkëngjitur dosjes së riorganizmit të programit, siç mund të vëreht më gjerësisht në evidencën nr. 38. Ky program është unik në Shqipëri dhe ka ardhur si kërkesë e KMSH për të plotësuar nevojat e veta me profesionistë të fushës. Këto të dhëna dhe vlerësime kanë ndikuar dhe në kuotat e përcaktuara për dy programet e Departamentit, në Bachelor dhe në Master Shkencor, por dhe duke gjykuar më konkretisht për aspekte të tilla si, gjendjen aktuale të tregut të punës; nevojat për burimet njerëzore; sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballlet kjo fushë; drejtimin e aktiviteteve sipas tregut të punës; sugjerime mbi ndryshimet e mundshme në programet mësimore të ofruara nga departamenti, këto me kusht që të përshtaten me trendin që ky treg po ndjek.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Në tërësinë e tij programi që është në fokus të këtij vlerësimi është në përputhje me interesat kombëtare të vendit tonë. Programi kontribuon për përgatitjen e profesionistëve në fushën e Shkencave Islame. Me njohuritë e thelluara dhe shprehitë praktike të fituara të diplomuarit e këtij programi janë të gatshëm për të kontribuar (një pjesë e tyre si e kemi përmendur janë të punësuar) në institucione të fushës së Shkencave Islame apo të përafërta me të, por dhe për ata që kanë rezultate të larta si dhe ambicie për të thelluar më tej njohuritë, ky nivel studimi i krijon mundësinë për të vijuar dhe në nivelin e tretë, për studime doktorale.</p> <p>Programi që është në fokus ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e vlerave kombëtare tek studentët që e frekuentojnë atë, si ata që janë banorë brenda territorit të Shqipërisë, ashtu dhe ata që vijnë nga trojet. Departamenti i Shkencave Islame në KUB ka zhvilluar dhe disa aktivitete në përmbushje të këtij synimi, siç mund të përmendim aktivitete e ndryshme ndërfaqëse të zhvilluara në mënyrë periodike çdo gjashtë muaj nga institucionet përfaqësuese të komuniteteve fetare në Shqipëri.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi Masterit Shkencor në Shkenca Moderne Islame realizohet me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje minimale 2 vjeçare.</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Nuk ofrohen cikël studimi "Master Profesional".</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Nuk ofrohen cikël studimi "Master Profesional".</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Syllabus-et pasi shpërndahen virtualisht për secilin nga studentët në adresën e emailit, rreth tyre zhvillohen dhe prezantime e detajime në takimet e drejtpërdrejta me pedagogun e lëndës. Kjo u pranua nga studentët e këtij programi gjatë kontaktit që pati me ta grupi i vlerësimit të jashtëm.</p> <p>Nga vizita në institucioni rezultoi se Institucioni merr masa për shpërndarjen e informacionit me anë të rrjeteve sociale, faqes zyrtare web, sitemit të informimit BIS, broshura dhe fletpalosje etj..</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Procesi i diplomimit është objekt në fluksin e informacionit që merr cdo student që frekuenton Programin Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame në KUB. Ky proces është dhe pjesë e Rregullores Themelore të institucionit, ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti deri në finalizimin e diplomimit të tij, siç e shohim në evidencë nr.5 në RVB.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ecurinë e programit Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame, evidentohet që sasia e krediteve për të dyja vitet e studimit është 120 ECTS. Ndërkohë që 30 ECTS janë lënë për finalizimin e tezës, kuotë kjo që është kusht për fitimin e diplomës në përfundim të programit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe nga takimet në institucion, arriti në këto përfundime:</p> <ol style="list-style-type: none"> Programi është në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim të institucionit. Programi merr parasysh kërkesat e tregut të punës, në lidhje të ngushtë me misionin dhe nevojat e KMSH. Programi synon jo vetëm ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare, por edhe përgatitjen e një teologu që i përshtatet Islamit shqiptar. Programi i studimit u mundëson studentëve si aftësimin profesional, ashtu edhe shprehje për kërkimin shkencor. Programi respekton kërkesat ligjore për sa i përket ngarkesës që duhet të zërë projekti kërkimor apo teza e masterit. Sistemi elektronik i informacionit BIS u mundëson studentëve informacion të plotë në 	

lidhje me programet e studimit, elementet përbërës të tyre, publikimet e ndryshme nga ana e institucionit, etj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Gjatv takimit me dekanin dhe pvrgegjvjsin e departamentin GVJ u informua se, në fillim të çdo viti akademik Kolegji ndjek një paketë masash për mbarëvajtjen e procesit mësimor sipas planeve të miratuara në rang institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë. Objekti kryesor mbetet verifikimi i ngarkesës mësimore për stafin akademik me kohë të plotë apo me të pjesshme, shpërndarja e lëndëve, dorëzimi i syllabuse-eve etj. Një grup pune i emëruar me urdhër të rektorit të Kolegjit ndjek gjithë këtë proces në mënyrë kapilare, në rang fakulteti, departamenti dhe programi konkret studimi në dy nivelet, Bachelor e Master. Për programin Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame, nga ana e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Departamentit të Shkencave Islame punohet për kombinimin e teknikave të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë krahas leksioneve dhe seminareve edhe zhvillimin e orëve të hapura të mësimi ku vijnë të ftuar ekspertë nga fusha e shkencave Islame, të cilët fokusohen në përvoja konkrete të terrenit, duke analizuar dhe prezantuar problematika aktuale. Angazhimi me detyrat e kursit dhe prezantimi i tyre është një tjetër format në kontrollin e njohurive dhe shprehive të studentëve në dy vitet e këtij programi, duke i angazhuar ata në një produkt konkret nga tematika që përfshihet në programin e lëndës. Si edhe u tha nga stafi akademik në takimin që GVJ pati me ta ,gjatë zhvillimit të procesit mësimor në auditor, pedagogët bëjnë në mënyrë sistematike kontroll të njohurive të studentëve, si gjatë diskutimeve në grup ashtu dhe përmes prezantimeve individuale të tyre. Ndiqen format standarde të provimeve të pjesshme si dhe ato finale, ndërkohë që studentët paraqesin dhe projekte në grup ose individuale. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me një rregullore për realizimin e provimeve që zbatohet në të gjithë Kolegjin, përfshirë dhe programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame.

Nga takimi me studentët GVJ konstaton se studentët në fillim të semestrit njihen me format e kontrollit të njohurive dhe strukturë e vlerësimit të tyre për secilën prej lëndëve që do të zhvillojnë. Pjesë e syllabus-it është dhe rubrika e mënyrës së vlerësimit të lëndës, e cila jep të ndarë në përqindje komponentët e notës (provimi pjesor, angazhimi në auditor, projekti ose detyra e kursit etj.). Bazuar në rezultatet që fiton studentit në shlyerjen e detyrimeve përlllogaritet dhe kreditet sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, ose ECTS. Duke qenë me grup me numër të vogël studentësh, këta të fundit ndjehen më të përfshirë gjatë seancave të seminareve apo diskutimeve. Studentët në takimin dhe bashkëbisedimin me grupin e ekspertëve të jashtëm u shprehën se vlerësojnë si të favorshëm në procesin e mësimdhënies nivelin e infrastrukturës brenda auditorëve, kushtet akomoduese, sistemet e kondicionimit të ajrit, tabelat interaktive (smart board-et), rrjeti i kompjuterave, aksesit në internet (wi-fi). Për angazhimin e pedagogëve në procesin mësimor dhe teknikat që ata përdorin për mësimdhënien merren vlerësime nga studentët dhe gjatë anketave që ata zhvillojnë dy herë brenda vitit akademik. Mendimet dhe propozimet e studentëve vlerësohen nga departamenti në favor të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu për garantimin e standardeve cilësore nga ana e stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, burimet njerëzore dhe NJSBC-ja organizojnë dhe trajnime e workshop-e, sipas pohimeve për grupin e ekspertëve të jashtëm nga ana e stafit akademik që është përfshirë me kohë të plotë ose të pjesshme në Departamentin e Shkencave Islame në KUB. Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Në standardin

që aplikon KUB, varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela nr. 14)

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Provime, Teza

Format e kontrollit të njohurive

Duke respektuar parimet e lirisë dhe autonomisë së pedagogut, Departamenti përcakton mënyrat dhe format e kontrollit edhe për programin MSc Shkenca Themelore Islame, duke i lënë autonomi lektorit. Ato përcaktohen në brendinë e syllabus-it përkatës për çdo lëndë. Nota përfundimtare e çdo lënde përbëhet nga testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. Forma e kontrollit të njohurive për lëndët e programit në shqyrtim përfshijnë disa komponentë: testin e ndërmjetëm (40 %); projektin e kursit ose analizën e një rasti studimor (në disa raste specifike – sipas diskutimit me pedagogët gjatë vizitës në institucion) (10-15%); dhe provimin përfundimtar (50-60%). Nga konstatimi gjatë vizitës rezultojnë se kjo nuk është forma e vetme e vlerësimit të lëndëve, pasi disa lëndë kanë natyrë më praktike ose pedagogu përgjegjës zgjedh raporte të ndryshëm midis këtyre komponentëve të vlerësimit, çka konsiderohet pozitive pasi rrit disi shkallën e autonomisë së tij. (Shih Tabelën 16 në Aneks)

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njohurive etj

Nga të dhënat e RVB (Tabela nr 17) dhe takimet në Departament rezultojnë se studnetët janë të përfshirë në aktivitetin shkencor të departamentit, në rang fakulteti si dhe tërhiqen në projekte të ndryshme kërkimore, qoftë individualisht nga pedagogë, qoftë në bashkëpunime me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në Departamentin e Shkencave Islame, për shkak të fizionomisë së tij, mësojnë një numër relativisht i kufizuar studentësh, çka ka krijuar mundësinë e një angazhimi maksimal të ekipit ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim.

Studentët e përfshirë në programin e ciklit të dytë në Shkenca Islame në KUB, deri në vitin 2015 janë pranuar bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pranimi për këtë kategori studentësh është përshtatur me kërkesat e këtij ligji, procedura që vijojnë të aplikohen dhe tani. Nga takimi me sekretarinë mesimore rezultojnë se, procedimi i pranimit të studentëve në çdo vit akademik, kuotat për programin e studimit që është në fokus, kriteret e pranimit etj., – janë pjesë e informacionit që KUB dërgon zyrtarisht pranë MASR-së për të gjithë programet në dy nivelet e studimit. Oferta publike për këtë program bëhet e njohur përmes faqes zyrtare të internetit, por dhe broshurave orientuese që shpërndahen brenda dhe jashtë

ambienteve të KUB, përmes takimeve të drejtpërdrejta, panairove etj. Ditët e Hapura, apo edhe ditët e orientimit për studentët e rinj, janë një formë tjetër e prezantimit të ofertës, të shpjegimeve dhe orientimit për të gjithë ata që shprehin interes në ndjekjen e programit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët pranohen në programet e ciklit të dytë, në bazë të kriterëve të mëposhtëme: Mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%. Intervista nga Komiteti Shkencor i Departamentit në masën 30%. Plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015. Plotësimi i kushtit të mjaftueshmërisë së gjuhës së studimit, për programin MSc që ofrohen në gjuhë të huaj, (turqisht, arabisht). Njohuritë gjuhësore përforcohen përmes një programi të veçantë dhe me një ngarkesë në orë mësimore që mbulohen nga departamenti. Dikumentacioni i nevojshëm që studentët duhet të dorzojnë për tu regjistruar janë:

- Diplomë bachelori e noterizuar (me vulë Apostille, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar për studentët e huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj)
- Listë notash (me vulë Apostille, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar për studentët e huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj)
- Diploma e shkollës së mesme, së bashku me listën e notave të noterizuar (me vulë Apostille, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar për studentët e huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj)
- 2 foto
- Çertifikatë e njohjes së gjuhës së huaj për studentët e masterit shkencor
- Fotokopje e mjetit të identifikimi (e pasaportës për studentët e huaj)
- Mandati i pagesës
- Leja e qëndrimit për studentët e huaj (dorëzohet deri në 3 muaj nga data e regjistrimit)

Nga verifikimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore, konstatohet respektimi i dokumentacionit të mësipërm.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

(Tabela nr. 18)

Mënyra dhe kushtet e transferimit të studentëve në programin “Master i Shkencave” në “Shkenca Themelore Islame” parashikohet në Rregulloren e ciklit të dytë të studimeve, neni 12 i saj.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

(Tabela nr. 18)

Nga të dhënat e RVB dhe të sekretarisë rezulton një rritje e notës mesatare të studentëve që regjistrohen në vitin parë.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, apo me drejtues të Departamentit dhe Fakultetit, si dhe nga njohja me dokumentacionin përkatës, grupi i ekspertëve të jashtëm u informua mbi standardin e KUB që lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe anasjellas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatës. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh. Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë: njohshmëria e programit të studimit dhe koha e kryerjes së studimeve. KUB ka Rregulloren për transferimin e studimeve, e cila shërben si bazë për procedurat që ndiqen dhe në Departamentin e Shkencave Islame. Departamenti në fjalë pjesë e Kolegjit Universitar Bedër ofron mundësi shkëmbimi për stafin akademik dhe studentët në bazë të marrëveshjeve me universitete brenda dhe jashtë vendit.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Nga të dhënat e RVB (Tabela 18) dhe vizita në institucion konstatohet se më shumë se gjysma e të diplomuarve, nga 21 të regjistruar, 11 të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën ndërsa 9 nuk janë në përputhje me diplomën.

Një pjesë e të diplomuarve në këtë program studimi vazhdojnë studimet pas universitare në vende të ndryshme të botës. Ka studentë që vazhdojnë jashtë ciklin e tretë të studimeve.

Numri total të diplomuarve

Janë diplomuar 21 studentë për periudhën 2013 – 2018.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Janë punësuar 11 të diplomuar për periudhën 2013-2018.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Janë 9 studentë të punësuar diploma e të cilëve nuk përputhet me diplomën për periudhën 2013-2018.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>KUB në rregulloren e institucionit, për të kryer studimet e ciklit të dytë, Master i Shkencave, (përfshirë dhe programin që është në fokus), ka si kusht pranimi për ata studentë që dëshirojnë ta ndjekin, që të kenë fituar së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë në Kolegj bazohet në kërkesat e ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi. Studentët që kërkojnë të ndjekin studimet në programin “Master i shkencave” në Shkenca Themelore Islame, plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga KUB dhe nga kuadri ligjor që është fuqi, miratuar nga MASR. Krahas përmbajtjes së rregullores së studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Themelore Islame, grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me disa praktika konkrete dosjesh të studentëve në Zyrën e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Kriteret ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%; • intervista nga Komiteti Shkencor i Departamentit përkatës, në masën 30%; • përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë; • plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015. <p>Ky kriter i fundit për pranimin e studentëve është përfshirë dhe në rregulloren përkatëse të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Themelore Islame. Në takimin me drejtues të Fakultetit dhe të Departamentit, si dhe në Zyrën e Sekretarisë Mësimore në KUB, grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me ndryshimet që bëheshin në kriteret e pranimi të studentëve, herë pas here, me synimin që të përmirësohej cilësia e kontingjentit që ofrohej për ciklin e dytë të studimeve, por gjithmonë ndryshimi bëhej duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi, miratuar nga MASR.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentë që ndiqnin këtë program studimi, ata pohuan se kishin informacion mbi mundësitë për punësim pas finalizimit të diplomimit në Master të Shkencave në Shkenca Themelore Islame. Interesimin më të madh e kishin studentët që nuk ishin ende në marrëdhënie pune ndërkohë që ndiqnin studimet. Në njoftimet që jepeshin dhe përmes webiste-t zyrtar të KUB, si dhe specifikisht të Departamentit të Shkencave Islame kishte shpjegime dhe për mundësitë për punësim të tyre në këtë fushë.</p> <p>Një student që interesohet për ndjekjen e studimeve në Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame, që para se të përgatisë dokumentacionin e aplikimit, i jepet informacion mbi akreditimin e KUB, apo të programeve, përfshi dhe programin që është në fokus, si dhe vlefshmërinë e diplomës që ai fiton. Këto njohuri janë pjesë e paketës së informacionit që shpërndahet me fletëpalosje, apo në mënyrë virtuale përmes webiste-t zyrtar të KUB. Java e parë e fillimit të vitit akademik në procesin e familjarizimit të studentëve me programin, përfshin dhe këto aspekte të akreditimit apo vlefshmërisë së diplomës që fitohet në përfundimin të studimeve dy vjeçare.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe studentëve nga të dyja vitet e programit, grupi i ekspertëve u njoh me shërbimin e këshillimit të karrierës. Konsulenca e Zyrës ishte për teknikat e konceptimit dhe shkrimit të CV-së, të prezantimit të punimeve dhe aktivitetit, orientimin në nevojat që ka aktualisht tregu i punës etj.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Zyra e të Diplomuarve në KUB, si pjesë e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, është e lidhur drejtpërdrejt me studentët që diplomohen dhe me të dhënat mbi punësimin e tyre. Gjatë takimit me përfaqësues të kësaj Zyre, si dhe me Sekretarinë Mësimore në KUB, grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me treguesit statistikorë mbi të diplomuarit, ku mbajtja e treguesve të tillë përcaktohet dhe në rregulloren mbi veprimtarinë e Sekretarisë.</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore u njohëm me tregues të tillë, si</p> <ul style="list-style-type: none"> - numri i studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë; - rastet e studentëve të tërhequr nga programi; - rastet e largimit para përfundimit të programit të studimit; - rastet kur studenti nuk e ka përfunduar me sukses vitin akademik - Gjithashtu Sekretaria Mësimore ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Sipas RVB dhe vizitës në institucion rezulton se Zyra e Sekretarisë Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Nga takimi me përgjegjësen e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit konstatuam se zyra mban një database në lidhje me studentët e diplomuar që vazhdojnë studimet në cikle të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe të dhena mbi punësimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe nga vizita në institucion pranë sekretarisë mësimore dhe Njsbc rezulton se studentëve por edhe anëtarëve të stafit akademik dhe administrativ ju behet i ditur procesi i akreditimit. Njoftimi realizohet me anë të shkresave të brendshme në mënyrë hierarkike nga rektori deri tek njesitë e tjera përbërëse të KUB. Gjithashtu ky informacion shpërndahet dhe përmes faqes zyrtare të internetit të institucionit. Siç është përmendur më sipër, studentët kanë mundësi të informohen dhe mbi programet e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit etj. Përmes sistemit të informimit të personalizuar, BIS, studentëve iu shpërndahet rezultati i vlerësimit, aspekte të arritjeve, dinamikës, rekomandime, analiza SWOT etj. Vlerësimet bëhen dhe objekt diskutimi të hapur me studentët që organizohet nga Departamenti, si një mekanizëm transparent dhe eficient në njohjen e dinamikës aktuale dhe perspektivës së programit të studimit.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Nga takimi me Zyrën e Këshillimit të Karrierës GVJ u informua se kjo zyrë ndjek nga afër ecurinë e studentëve, dhe asiston problematikave që ata hasin në zhvillimin e procesit mësimor në auditor apo jashtë tij.</p> <p>Kjo zyrë u kushton rëndësi edhe planifikimit për zhvillimin e praktikave profesionale, si pjesë e programit mësimor në ciklin e dytë të studimeve. Në bashkëpunim me drejtuesit në Departament kjo zyrë harton një listë të institucioneve potenciale për realizimin e praktikës profesionale, e cila konsultohet me studentët për të precizuar caktimin e tyre në secilin prej ofertave që janë në funksion dhe të fushës ku fokusohet më shumë një student. Nga takimi me studentët rezultoi se, një pjesë e studentëve janë të punësuar brenda profilit të programit dhe ata e vijnë praktikën profesionale po aty. Të tjerët konsultohen me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Departamentin për të zhvilluar praktikën në një institucion sa më të përshtatshëm në realizimin e praktikës profesionale.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe verifikimeve ne Sekretarinë mesimore e takimeve ne Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Konstatohet se Institucioni ka ngritur zyrën e Karrieres dhe Alumnit e cila i vjen në ndihmë studentëve duke i informuar mbi punësimin dhe planifikimin e karrieres pas përfundimit të studimeve.
- b. Regjistrimi i studentëve në këtë program studimi behet ne përputhje me “Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” dhe akte nënligjore të tij.
- c. Konstatohet se Institucioni mban të informuar studentët dhe stafin mbi vlerësimin e programeve të studimit dhe politikave Institucionale.
- d. GVJ konstaton se institucioni mban statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar si dhe të dhena që lidhen me punësimin e tyre.
- e. GVJ konstatoi se studentët mbështeten me anë të personelit përkatës, siç është Zyra e Planifikimit të Karrierës që ofron shërbim këshillimi, Këshilltari Akademik apo Koordinatori i Programit Master që merret me kriteret e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe detyrimet e tjera të lidhur me të.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e situara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Krahas veprimtarisë mësimore, departamenti i ka kushtuar vëmendje veprimtarisë kërkimore shkencore. Institucioni stimulon kërkimin shkencor duke mbështetur financiarisht pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari. Edhe organizimi ose bashkëorganizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar e pjesëmarrja në to është një tjetër aspekt dallues i departamentit të Shkencave Islame. Kjo ndihmohet edhe nga funksionimi i Zyrës së Kërkimit Shkencor, pjesë e strukturës së Institucionit, e cila luan një rol të rëndësishëm në fushën e organizimit e nxitjes së kërkimit dhe projekteve shkencore. Në Departament ndiqet politika e lirisë akademike dhe autonomisë individuale, bazuar në misionin e vetë Institucionit që, me anë të udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Departamenti, në kuadër të institucionit është partner në bashkëpunimin me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit; KUB ka nënshkruar Kartën për Studiuesit Evropianë, në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit Horizont 2020. (Tabela nr. 19, 20 dhe 21 si dhe Evidenca nr 32).

Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga institucioni dhe përgjigjet për financimin e grupeve kërkimore. Bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore, departamenti sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e bashkëpunimit me to. Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i rendimentit të ekipit akademik, bazuar në reagimin e marrë në vlerësimin e punës shkencore, në bazë të treguesve transparentë të botuar në rregulloret përkatëse. Në programin e ciklit të dytë i kushtohet vëmendje lidhjes së kërkimit shkencor me mësimdhënien, që pasqyrohet në politikën e nxitjes

së studentëve për të ndërmarrë kërkime shkencore. Si rezultat, janë botuar një sërë artikujsh si dhe është realizuar dhe pjesëmarrja e studentëve në konferenca të ndryshme, ndërsa çdo vit organizohet Konferenca Ndërkombëtare e Studiuesve të Rinj. Nga të dhënat e RVB dhe vizita në institucion, konstatohet se Departamenti i Shkencave Islame zhvillon një aktivitet të pasur shkencor, të pasqyruar në numrin e konferencave të organizuara brenda vendit dhe jashtë si dhe në botimet e ndryshme shkencore. (Evidenca "Publikime dhe Projekte të Personelit: Tabela nr.19 dhe 20)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
